



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 660 Akti

Nr. 779 Vendimi
Tiranë, më 28.6.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu Kryesuese
Roland Ilia Relator
Genta Tafa (Bungo) Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 27.6.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Aurel Zarka**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- 1.** Subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
- 2.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
- 3.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në dhjetor të vitit 2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Suela Zhegu. Relator i çështjes u zgjodh me short komisioneri Roland Ilia, ndërsa kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim komisionerja Suela Zhegu. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Më pas u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Aurel Zarka sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.
- 4.** Subjektit të rivlerësimit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit sipas kërkesës së Komisionit ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.
- 5.** Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, vlerësimi i aftësive profesionale.
- 6.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 5.6.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Aurel Zarka; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

7. Subjekti i rivlerësimit, pas njoftimit mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, të cilat i paraqiti në rrugë zyrtare pranë Komisionit, në datën 20.6.2024.

8. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë z. Aurel Zarka në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

9. Subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 21.6.2024.

10. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 27.6.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

11. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet e opinionet në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

12. Z. Aurel Zarka ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Procesi i rivlerësimit/hetimi administrativ i kryer nga Komisioni

13. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

14. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese

¹ 41. Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre

dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

15. Bazuar në nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka, ku konstatohet se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *ka mosdeklarim të pasurisë ndër vite;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

16. Z. Aurel Zarka është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI nga viti 2012 si prokuror dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private periodike.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

17. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit duke iu referuar dokumentacionit:

- Raporti i ardhur nga ILDKPKI-ja dhe dosja për vlerësimin e pasurisë:
 - ✓ deklarata *Vetting* e dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së sipas ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003;
 - ✓ dokumentet e ndodhura në dosjen e dërguar nga ILDKPKI-ja.
- Dokumentacioni i administruar nga Komisioni të paraqitura nga institucionet publike dhe private sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016:
 - ✓ deklaratimet e subjektit dhe provat e dërguara në përgjigje të pyetësorëve.
- Raporti i administruar nga AKSIK-ja për kontrollin e figurës:
 - ✓ formulari i plotësuar i kontrollit të figurës;
 - ✓ hetimi administrativ nga Komisioni.
- Aktet e administruara për vlerësimin profesional:
 - ✓ raporti profesional paraqitur nga KLP-ja.
- Denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016:
 - ✓ dokumentacioni i depozituar nga denoncuesit pranë Komisionit.

Në deklaratën e pasurisë, shtojca *, dorëzuar në ILDKPKI në datën 20.1.2017 (deklarata *Vetting*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti ka deklaruar:**

kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

1. Apartament banimi + garazh, në S, Tiranë

1.1 Subjekti ka deklaruar apartament në Tiranë me nr. pasurie ***, bashkë me garazhin me nr. pasurie *** dhe garazhin me nr. pasurie ***, blerë në shumën 84,000 euro së bashku.

1.2 Burimi i krijimit është nga kursimet e subjektit dhe të bashkëshortes nga të ardhurat e punësimit deri në momentin e blerjes së këtij apartamenti. Këto kursime janë rreth 8,000,000 lekë (vërtetimet e pagave bashkëlidhur). Gjithashtu, për blerjen e apartamentit dhe garazheve është përdorur shuma 40,000 euro, e cila është përfituar nga marrëveshja e lidhur me shtetasin H.Sh. Zotërimi: 50%.

Hetimi i Komisionit

1.3 Rezultoi se me anë të kontratës noteriale së shitblerjes nr. ***, datë 24.5.2015, subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. këto pasuri të paluajtshme:

- a) pasurinë apartament me sip. 110.4 m² + sipërfaqe e përbashkët 13.4 m², sipërfaqe totale 124 m², nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, S, Tiranë;
- b) pasurinë garazh me sip. 20 m², nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, S, Tiranë;
- c) pasurinë garazh me sip. 20 m², nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, S, Tiranë.

1.4 Çmimi total i blerjes së këtyre 3 pasurive të paluajtshme sipas kontratës së shitblerjes është në vlerën 84,000 euro, e cila është likuiduar tërësisht.

1.5 Bazuar në certifikatën për vërtetim pronësie nr. ***, datë 22.2.2016, apartamenti me sip. 110.40 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, në S, Tiranë, është në bashkëpronësi të shtetasve Aurel e S.Z.

1.6 Bazuar në certifikatën për vërtetim pronësie nr. ***, datë 22.2.2016, garazhi me sip. 20 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, në S, Tiranë, është në bashkëpronësi të shtetasve Aurel e S.Z.

1.7 Bazuar në certifikatën për vërtetim pronësie nr. ***, datë 22.2.2016, garazhi me sip. 20 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, në S, Tiranë, është në bashkëpronësi të shtetasve Aurel e S. Z.

1.8 Në dokumentacionin pjesë e dosjes *Vetting*, subjekti ka depozituar ndër të tjera edhe: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë lëshimi 22.2.2016, në të cilën pronarë të apartamentit me sip. 110.4 m² në S, Tiranë, janë subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij; (ii) certifikatë për vërtetim pronësie nr. *** dhe nr. ***, datë lëshimi 22.2.2016, në të cilën pronarë të dy garazheve (me nga 20 m² secili) në S, Tiranë, janë subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij.

1.9 Me shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2024, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë hetuar palën shitëse të këtyre pasurive të paluajtshme, shtetasin J.M dhe shoqërinë “ ****” sh.p.k.

1.10 Për këto pasuri është lidhur në fillim një kontratë në datën 22.6.2012 (dokument i thjeshtë), ku subjekti i rivlerësimit ka rënë dakord për blerjen nga shoqëria ndërtimore “****” sh.p.k. të një apartamenti me sipërfaqe totale 124 m² dhe dy garazheve, me sipërfaqe nga 20 m² secili, në vlerë totale 84,000 euro, nga e cila shuma prej 64,000 euro është paguar datën e lidhjes së kontratës dhe shuma prej 20,000 euro do të shlyhej brenda dhjetorit 2013.

1.11 Më pas është lidhur një kontratë noteriale sipërmarrjeje nr. ***, datë 1.10.2012, ku investitori sipërmarrës, shoqëria “****” sh.p.k., ka marrë përsipër të ndërtojë objektin dhe t’i dorëzojë porositësit Aurel Zarka apartamentin *** (2+1) me sipërfaqe totale 120 m², në vlerën 84,000 euro. Në këtë kontratë parashikohet se: *“Shuma prej 79,000 euro do të paguhet me nënshkrimin e kësaj kontrate, ndërsa vlera prej 5,000 euro do të paguhet në një moment të dytë”*.

1.12 Lidhur me kohën, mënyrën e pagesës së çmimit total të blerjes së kësaj pasurie, si dhe burimin e të ardhurave për secilën pagesë të kryer, është pyetur subjekti i rivlerësimit i cili ka kthyer përgjigje sipas pyetësorit nr. ***².

1.13 Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar se: *“Deklarimi para fillimit të detyrës nga ana ime është kryer në datën 1.10.2012 dhe ka përfshirë të gjitha pasuritë e mia deri në datën e dorëzimit të asaj deklarate dhe jo deri në momentin e marrjes së detyrës, pasi në këtë mënyrë është kuptuar nga ana ime”*.

Mbi burimin e krijimit të pasurive

1.14 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se kjo pasuri në pjesën 50% është krijuar nëpërmjet kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.5.2015. Si burim subjekti ka deklaruar kursimet e tij dhe të bashkëshortes nga të ardhurat nga punësimi deri në momentin e blerjes së këtyre pasurive (këto kursime janë rreth 8,000,000 lekë)³, si dhe shumën 40,000 euro, e cila është përfituar nga marrëveshja e lidhur me shtetasin H.Sh .

1.15 Për sa i përket marrëveshjes së lidhur me shtetasin H.Sh , rezultoi se sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 16.6.2016, ky shtetas, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, deklaroi se në vitin 2001, për nevoja investimi në shoqëri, ka marrë *cash* nga shtetasi T.Z (babai i subjektit të rivlerësimit) shumën 40,000 USD, e cila do t’i kthehej bashkë me interesa.

1.16 Bazuar në këtë deklaratë, theksohet se në vitin 2007 këtë shumë të konvertuar në euro (pasi dakordësuan për kursin e dy monedhave 40,000 euro) ia ka kthyer djalit të shtetasit T. Z, subjektit Aurel Zarka. Gjithashtu, meqenëse shumën e marrë hua prej 40,000 USD shoqëria e përdori për investime dhe nxori fitime, ka prenotuar në emër të z. Aurel Zarka një apartament banimi sipas kontratës nr. ***, datë 1.11.2007, vlera e të cilit u pagua nga shoqëria “****” sh.p.k. sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 20.3.2013, në të cilën cilësohet se çmimi 27,000 euro është likuiduar nga shoqëria “****” sh.p.k. me kliring.

1.17 Rezultoi se me anë të kontratës nr. ***, datë 26.6.2001, babai i subjektit të rivlerësimit, z. T.N.Z, ka lidhur para noterit A. M një kontratë huaje me shtetasin H.N.Sh . Sipas kësaj kontrate huaje, shtetasi T.Z i jep shtetasit H.Sh shumën 40,000 USD, i cili do ta përdorë atë për qëllime investimi. Kjo kontratë është me afat 5-vjeçar. Me mbarimin e afatit të kësaj

² Shihni përgjigjet e subjektit mbi pyetësorin nr. *** në dosjen e Komisionit.

³ Me cilësim “Vërtetimet e pagave bashkëlidhur”.

kontrate huaje, shtetasi H.Sh detyrohet t'i kthejë shtetasit T.Z shumën 40,000 USD dhe një apartament në qytetin e Vlorës, jo më të vogël se 60 m².

1.18 Subjekti është pyetur lidhur me kohën dhe mënyrën (*cash* apo nëpërmjet bankës) e marrjes prej tij dhe familjarëve të shumës prej 40,000 euro, se cila ka qenë pjesa takuese e tij dhe cili ka qenë destinacioni i saj.

1.19 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar: “Referuar dhe deklaratës noteriale nr. ***, datë 16.6.2016, të lëshuar nga shtetasi H.Sh , shuma është kthyer në vitin 2007, në masën 40,000 euro, në *cash*, ndërsa interesat mbi këtë shumë janë përfituar në natyrë dhe përfaqësuar nga apartamenti i banimit 1+1, sipas kontratës së prenotimit datë 1.11.2007, me nr. *** dhe finalizuar sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 20.3.2013, me një vlerë prej 27,000 euro, e cila u pagua nga huamarrësi, shoqëria “****” sh.p.k.

*Referuar deklaratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.8.2006, lëshuar përpara noteres K. P, trashëgimtarët e të ndjerit T.Z, nëna ime F.Z, unë dhe motra ime M.Z, është deklaruar se: “Duke qenë se huaja dhe interesat, lindur nga të drejtat e trashëgimlënësit tonë, të ndjerit T.Z, ende nuk janë kthyer nga huamarrësi, autorizojmë djalin dhe vëllain tonë, shtetasin Aurel T.Z që, në lidhje me këto të drejta dhe detyrime të shtetasit H.Sh që rrjedhin nga marrëdhënia e huamarrjes, të përdorë shumën e dhënë hua nga i ndjeri, duke pasur të drejtë ta arkëtojë atë dhe interesat përkatës, si dhe të përdorë lirisht dhe pa kufizim të gjitha të drejtat që mund të vijjnë nga kjo huadhënie”.*

Në këto kushte, shuma prej 40,000 euro është përdorur nga ana ime për blerjen e apartamentit në qytetin e Tiranës, në vitin 2012, duke qenë dhe apartamenti 1+1 në pronësinë time, në përputhje me deklaratën e mësipërme”.

1.20 Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2024, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë hetuar shtetasin H.Sh ose shoqërinë “****” sh.p.k.

Analizë e burimit të të ardhurave për blerje të këtyre pasurive dhe mundësia financiare

1.21 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim të të ardhurave kursimet e tij dhe të bashkëshortes nga të ardhurat nga punësimi deri në momentin e blerjes së këtyre pasurive (këto kursime janë rreth 8,000,000 lekë), si dhe shuma 40,000 euro, e cila është përfituar nga marrëveshja e lidhur me shtetasin H.Sh .

1.22 Në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “****” sh.p.k., tetor 2012, për blerje ap. banimi me sip. 120 m² në komunën F (ndërtim i papërfunduar) në shumën totale 84,000 euro (paguar 79,000 euro). Burimi: të ardhura familjare (burimi kryesor të ardhurat nga aktiviteti profesional i babait si teknik ndërtimi nga viti 1991 – 2002)”.

1.23 Në deklaratën e interesave private për vitin 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim “të ardhura familjare” për pagesën e shumës 79,000 euro (pjesë e çmimit total prej 84,000 euro të blerjes së apartamentit me sip. 120 m² tek shoqëria “****” sh.p.k.).

1.24 Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2015, subjekti ka deklaruar ndër të tjera kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.5.2015, blerë në shumën 84,000 euro, nga të cilat 79,000 euro janë paguar në vitin 2012, kurse 5,000 euro të paguara nga kursimet e pagës në vitet e fundit, si dhe të ardhurat nga shitja e automjetit tip “****”.

1.25 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar: “...Në datën 22.6.2012 kam kryer shpenzim të menjëhershëm për blerjen e apartamentit në rr. “****”, nd. ***, shk. ***, ap. ***, S, Tiranë, në shumën 64,000 euro. Pagesa është kryer jashtë sistemit bankar në favor të shoqërisë “****”. Burimi i të ardhurave është nga kursimet e mia dhe të bashkëshortes, nga të ardhurat e punësimit deri në momentin e blerjes së këtij apartamenti. Këto kursime kanë qenë rreth 8,000,000 lekë. Gjithashtu, për blerjen e apartamentit dhe garazheve është përdorur shuma prej 40,000 euro, e cila është përfituar nga marrëveshja e lidhur me shtetasin H.Sh .

Në datën 3.12.2013 kam kryer shpenzim të menjëhershëm për këstin e blerjes së apartamentit të ndodhur në rrugën “*** ”, në shumën 15,000 euro. Pagesa është kryer jashtë sistemit bankar në favor të shoqërisë “**** ” sh.p.k. Mandati i arkëtimit që disponoj lidhur me këtë pagesë është në shumën 20,000 euro, por me marrëveshje verbale me përfaqësuesin e shoqërisë ramë dakord që shuma prej 5,000 euro të paguhej pas marrjes së certifikatës së pronësisë... Burimi i të ardhurave është nga kursimet e mia dhe të bashkëshortes, nga të ardhurat e punësimit deri në momentin e blerjes së këtij apartamenti. Këto kursime kanë qenë rreth 8,000,000 lekë. Gjithashtu, për blerjen e apartamentit dhe garazheve është përdorur shuma prej 40,000 euro, e cila është përfituar nga marrëveshja e lidhur me shtetasin H.Sh ...

Në vitin 2015 kam kryer shpenzim të menjëhershëm për këstin e blerjes së apartamentit të ndodhur në rrugën “*** ”, në shumën 5,000 euro. Pagesa është kryer jashtë sistemit bankar në favor të shoqërisë “**** ”. Burimi i të ardhurave është nga kursimet e mia dhe të bashkëshortes, nga të ardhurat e punësimit deri në momentin e blerjes së këtij apartamenti. Këto kursime kanë qenë rreth 8,000,000 lekë. Gjithashtu, për blerjen e apartamentit dhe garazheve është përdorur shuma prej 40,000 euro, e cila është përfituar nga marrëveshja e lidhur me shtetasin H.Sh ”.

1.26 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** në lidhje me pagesat e kryera, subjekti ka sqaruar: “...shuma prej 64,000 euro në datën 22.6.2012, sipas kontratës midis palëve, e paguar në cash. Burimi kryesor i të ardhurave për këtë pagesë ka qenë nga të ardhurat familjare ndër vite, të siguruara kryesisht nga im atë në periudhën 1991 – 2002 si profesionist në ndërtim.

Në lidhje me të ardhurat e tim eti, shtetasit T.Z, ju referoj edhe deklaratën noteriale nr. *** datë 16.6.2016, të dhënë nga shtetasi H.Sh , me të cilën deklarohet faktin se në vitin 2001 shoqëria “**** ” sh.p.k., e përfaqësuar nga administratori, z. H.Sh , ka marrë hua nga i ndjeri im atë, T.Z, shumën prej 40,000 USD për aktivitetin e shoqërisë tregtare, e cila do të kthehej me interesa. Vlera 40,000 USD është përdorur për investim nga shoqëria “**** ” sh.p.k. dhe është kthyer në vitin 2007 në monedhën euro⁴ dhe, përveç kësaj shume, si interes është prenotuar nga “**** ” sh.p.k. edhe një apartament banimi 1+1 sipas kontratës së prenotimit datë 1.11.2007,

⁴ Subjekti ka vënë në dispozicion edhe kontratën e huas nr. ***, datë 26.6.2001, midis shtetasit H.Sh si huamarrës dhe babait të subjektit T. Z si huadhënës, lidhur përpara noteres A.M, me të cilën rezulton të jetë dokumentuar dhënia hua e vlerës 40,000 USD për një afat kohor 5-vjeçar, e cila do të kthehej me interes, i përfaqësuar nga një apartament banimi në qytetin e Vlorës, jo më i vogël se 60 m².

me nr. *** dhe finalizuar sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 20.3.2013, me një vlerë prej 27,000 euro.

Po ashtu, si burim tjetër për pagesën e këstit të parë prej 64,000 euro në datën 22.6.2012 kanë shërbyer edhe kursimet e të ardhurat nga pagat e mia dhe të bashkëshortes deri në momentin e kryerjes së pagesës.

* Shuma prej 15,000 euro në datën 1.10.2012 është paguar në këtë datë cash sipas kontratës së sipërmarrjes nr. ***, lidhur me shoqërinë “*** ” sh.p.k., duke plotësuar vlerën prej 79,000 euro (64,000 euro paguar në datën 22.6.2012 + 15,000 euro paguar në datën 1.10.2012).

Burimi i kësaj shume janë të ardhurat nga pagat e mia dhe të bashkëshortes, si dhe kursime familjare”.

1.27 Gjithashtu, subjekti ka sqaruar: “Referuar mandatarkëtimin të datës 3.12.2013 për pagesën e shumës 20,000 euro, sqarohet faktin se kjo është cilësuar e tillë për shkak të vonësës në punimet e shoqërisë “*** ” sh.p.k. në këtë objekt, duke më garantuar se nëse punimet nuk do të realizoheshin sikurse ishte parashikuar në kontratë, shuma prej 5,000 euro, ende e papaguar deri në atë moment, do të konsiderohej e likuiduar. Sikurse konstatohet edhe nga përmbajtja e mandatarkëtimin datë 3.12.2013, ai referon të gjithë shumën prej 20,000 euro si të paguar në datën 3.12.2013, në një kohë kur vlera prej 15,000 euro, siç cilësuam, ishte paguar që në datën 1.10.2012, kur ishte lidhur kontrata e sipërmarrjes ***.

Në vijim të sa më lart, referoj edhe mandatarkëtimin e lëshuar nga shoqëria “*** ” sh.p.k. në datën 24.5.2015, dita kur u lidh kontrata përfundimtare e shitblerjes dhe palët u likuiduan plotësisht midis tyre për pagesat. Me këtë mandat arkëtimin konstatohet pagesa e vlerës prej 4,130 euro, e cila përbën pagesën e pjesshme të vlerës së mbetur prej 5,000 euro, në kushtet kur sipërmarrësi “*** ” sh.p.k. kishte realizuar punimet sipas dakordësisë, duke u zbritur nga ajo vlerë shuma prej 870 euro, e cila përfaqëson vlerën e 5 dyerve të brendshme dhe 2 kompleteve hidrosanitare, të cilat ishin vendosur nga ana ime.

Burimi i të ardhurave për vlerën prej 4.130 euro ka qenë nga të ardhurat e shitjes së automjetit tip “***” në vitin 2014, të cilat ishin gjendje cash dhe kursime familjare”.

1.28 Sa më sipër, duket se ka mospërputhje në kohën e pagesës së shumës 15,000 euro (kësti i dytë i çmimit të blerjes së apartamentit në S, Tiranë), pasi:

i) Në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës në vitin 2012, datë dorëzimi 1.10.2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “*** ” sh.p.k., tetor 2012, për blerje apartamenti banimi me sip. 120 m² në komunën F (ndërtim i papërfunduar), në shumën totale 84,000 euro (paguar 79,000 euro)”.

ii) Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar: “...në datën 3.12.2013 kam kryer shpenzim të menjëhershëm për këstin e blerjes së apartamentit të ndodhur në rrugën “*** ”, në shumën 15,000 euro. Pagesa është kryer jashtë sistemit bankar në favor të shoqërisë “***”.

iii) Në përgjigje të pyetësorit nr. *** në lidhje me pagesat e kryera, subjekti ka deklaruar: “Shuma prej 15,000 euro në datën 1.10.2012 është paguar në këtë datë në cash, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** lidhur me shoqërinë “*** ” sh.p.k., duke plotësuar vlerën prej 79,000 euro (64,000 euro paguar në datën 22.6.2012 + 15,000 euro paguar në datën 1.10.2012)”.

1.29 Komisioni ka vlerësuar të pasqyrojë në analizën financiare si këste dhe kohë pagese: në datën 22.6.2012 shuma 64,000 euro; në datën 1.10.2012 shuma 15,000 euro dhe në vitin 2015 shuma 5,000 euro.

1.30 Analizë e burimit të të ardhurave për pagesën e kështit të parë dhe të dytë të çmimit të blerjes së këtij apartamenti

a. Kursimet nga të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes

Në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës në vitin 2012, datë dorëzimi 1.10.2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “***”, tetor 2012, për blerje apartament banimi me sip. 120 m² në komunën F (ndërtim i papërfunduar), në shumën totale 84,000 euro (paguar 79,000 euro). Burimi: të ardhurat familjare (burimi kryesor të ardhurat nga aktiviteti profesional i babait si teknik ndërtimi nga viti 1991 – 2002)”.

Analiza në lidhje me mundësinë e kursimeve të subjektit dhe personave të lidhur është pasqyruar sipas tabelës nr. 1 (për periudhën prill 2001 – 6.6.2012) dhe tabelës nr. 2 (për periudhën 7.6.2012 – 31.12.2012).

Analiza financiare për burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie

1.31 Komisioni, mbështetur në dokumentacionin e administruar, kreu një analizë financiare gjithëpërfshirëse për periudhën prill 2001 deri në datën 6.6.2012, datë në të cilën subjekti ka nisur punë si prokuror, për të evidentuar mundësinë financiare nga të ardhura të dokumentuara të subjektit dhe personave të lidhur për krijim të pasurive⁵ (përfshirë edhe kursime në llogari bankare) dhe kryerjen e shpenzimeve. Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat e subjektit dhe personave të lidhur, blerjet/shitjet e pasurive, si dhe shpenzimet e kryera për këtë periudhë, konkretisht:

Analiza e treguesve financiarë për periudhën prill 2001 – 6.6.2012	
Përshkrimi	Vlera në lek
Të ardhura neto nga marrëdhëniet e punësimit, subjekti, dokumentuar për periudhën	7658533
Të ardhura nga marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortes për periudhën 1.1.2009 – 6.6.2012	3376307
Të ardhura nga përfitime sig. shoqërore, viti 2010, bashkëshortja	356815
Të ardhura përfituar nga kontrata e shitjes e datës 7.9.2004, shuma 1,500,000 lekë	1500000
Të ardhura përfituar nga kontrata e shitjes e datës 18.9.2006, shuma 2,000,000 lekë	2000000
Të ardhura përfituar nga kontrata e shitjes e datës 14.10.2006, shuma 1,900,000 lekë	1900000
Të ardhura neto të përfituar shitja e ap. në Tiranë kontratë shitjeje datë 31.10.2008, në shumën 4.318.800 lekë	2104700
Të ardhura përfituar nga kontrata e shitjes e datës 3.9.2010, shuma 227,000 lekë	227000
Të ardhura përfituar nga kontrata e shitjes e datës 3.9.2010, shuma 227,000 lekë	227000
Të ardhura përfituar nga kontrata e shitjes e datës 3.6.2011, shuma 339,592 lekë	339592
Të ardhura nga interesa bashkëshortja 1.1.2009 – 6.6.2012	92422
Të ardhura nga interesa bankarë, subjekti, për periudhën	1209775
Të ardhura nga huadhënia e babait nga kursime deri në 2001 (kthyer në vitin 2007, deklaruar)	4871200
Të ardhura nga kontrata e huas së babait në vitin 2001(sistemim)	3356660

⁵ Përfshirë edhe pasurinë apartament në Vlorë me sip. 84 m².

Të ardhura/bonus fëmija 2010	5000
Të ardhura/për shpenzime seminari, Kroaci, viti 2009	22625
Të ardhura të dokumentuara, nëna (pension familjar 2.11.2011 – qershor 2012)	46762
Të ardhura të dokumentuara, motra (pension familjar 5.3.2002 – 31.8.2006)	233138
Të ardhura të dokumentuara, motra, nga punësimi për periudhën nga 1.8.2006 – 6.6.2012)	3930237
Total të ardhura/të hyra financiare	33457766
Pagesë për blerje ap. me sip. 84 m ² , pranë *** Vlorë, blerë në vitin 2007 në shumën 28,800 euro	3356660
Pagesë për blerje ap. me sip. 99 m ² tek shoqëria “****” sh.p.k., porositur në vitin 2006	5301900
Pagesë për blerje ap. me sip. 49 m ² tek shoqëria “****” sh.p.k. nga motra e subjektit dhe shtetasi F. N., 2,107,000 lekë (vendosur pjesa 1,500,000 lekë e motrës, shlyer viti 2008)	1500000
Shpenzim mobilimi ap. Vlorë, deklaruar (2011 – fillim 2012)	300000
Tatime për shitje të pasurive, shuma deklaruar pyetëtori nr. ***	64356
Tatim mbi interes bono thesari 2009 – 2010	37877
Shpenzim interesa bankarë të paguar (sistemim)	56826
Shpenzime për udhëtim dhe qëndrim jashtë vendit për periudhën	471793
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën	4186394
Total shpenzime/të dala financiare	15275806
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim – gj. fund periudhe	
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim – gj. fund periudhe	-9742891
Mjete monetare të disponueshme	8439069

Tabela nr. 1

1.32 Sa më sipër, rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi financiare për krijim të pasurive dhe kryerje të shpenzimeve të deklaruara dhe të llogaritura për periudhën deri në datën 6.6.2012.

1.33 Në vijim të analizës si më sipër pasqyruar (duke përfshirë edhe mjetet monetare të disponueshme në datën 6.6.2012), Komisioni kreu një analizë financiare për periudhën 7.6.2012 – 31.12.2012, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personave të lidhur për pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit në S, Tiranë, në shumën 79,000 euro (këstin e parë dhe të dytë), shtesën në pasuri të luajtshme, si dhe kryerjen e shpenzimeve të vetëdeklaruara dhe të evidentuara për këtë periudhë, duke përfshirë në analizë konkretisht:

Tabela nr. 2

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 7.6.2012 – 31.12.2012	
Përshkrimi	Vlera në lek
Të ardhura neto nga marrëdhëniet e punësimit të subjektit, dokumentuar për periudhën	421599
Të ardhura nga marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortes për periudhën	491295
Të ardhura të dokumentuara, nëna, qershor 2012 – 1.9.2012	20563
Të ardhura të dokumentuara, motra, për periudhën	169026
Të ardhura të tjera, interesa	375192
Hua nga shtetasi L në shumën 35,000 euro	4885650
Shumë e kthyer nga motra në datën 27.9.2012 në Raiffeisen Bank (shlyerje e kështit të shtëpisë)	1500000
Total të ardhura/të hyra financiare	7863325
Shpenzim për pagesë të kësteve të blerjes së apartamentit në shumën 79,000 euro	11027610
Shpenzim për blerje automjeti tip “***”, në datën 30.7.2012, në shumën 3,500 euro	488565
Shpenzime për automjetin tip “***”, deklaruar	100000
Shpenzime për udhëtim dhe qëndrim jashtë vendit për periudhën	123956
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën	304329
Total shpenzime/të dala financiare	12044460
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim – gj. fund periudhe	8439070
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim – gj. fund periudhe	-4037220
Mjete monetare të disponueshme	220715

1.34 Sa më sipër, rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi financiare për krijim të pasurive (përfshirë edhe pagesën e 2 kësteve të para të çmimit të blerjes së apartamentit dhe garazheve në S, Tiranë, në shumën 79,000 euro) dhe kryerje të shpenzimeve të deklaruara dhe të llogaritura për periudhën 7.6.2012 – 31.12.2012.

b. Shuma 40,000 euro përfituar nga marrëveshja e lidhur me shtetasin H.Sh

Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.6.2016⁶, shtetasi H.Sh ka deklaruar: “...Në cilësinë e administratorit të shoqërisë “*** ” sh.p.k. (NIPT ***), për nevoja investimi të aktivitetit të shoqërisë në fushën e ndërtimit, në vitin 2001, mora cash në dorë nga i ndjeri T.Z një shumë prej 40,000 USD. Sqaroj se të ndjerin T. Z., i cili ishte me profesion teknik ndërtimi, kisha rreth 2 vjet që e njihja, pasi kishim bashkëpunuar edhe më parë në fushën e ndërtimit, duke qenë se ai në atë periudhë kohe kishte krijuar një brigadë ndërtimi, duke vlerësuar korrektësinë e marrëdhënies sonë, për shumën 40,000 USD nuk bëmë marrëveshje me shkrim, por ramë dakord verbalisht që për shumën në fjalë në momentin e likuidimit shoqëria detyrohej edhe interesa.

Në vitin 2007 i ktheva djalit të tij, në bazë të marrëveshjes së bërë me të atin, një shumë prej 40,000 euro, pasi ramë dakord për kursin e këmbimit të dy monedhave, USD dhe euro. Gjithashtu, duke qenë se shoqëria “*** ” sh.p.k. e përdori për investime shumën prej 40,000 USD dhe nxori fitime prej saj, prenotova në emër të djalit të të ndjerit edhe një apartament banimi me strukturë 1+1 e ambiente ndihmëse sipas kontratës së prenotimit datë 1.11.2007, vlera e të cilit u pagua nga shoqëria “*** ” sh.p.k., vërtetuar kjo me kontratën e shitjes datë 20.3.2013, nr. ***, ku konkretisht në përmbajtje të saj është cilësuar “pala shitëse ia shet palës

⁶ Dokumentacion ***, dosja *Vetting*.

blerëse kundrejt çmimit në total 27,000 euro, shumë e cila është likuiduar nga shoqëria “****” sh.p.k. me kliring...”.

1.35 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka depozituar edhe kontratën noteriale të huas nr. ***, datë 26.6.2001, ndërmjet shtesave H.Sh dhe T.Z, ku është dakordësuar dhënia e shumës 40,000 USD nga z. Z për një periudhë 5-vjeçare, si dhe ka sqaruar se: “Në lidhje me këtë marrëveshje të babait tonë të ndjerë, jam vënë në dijeni në vitin 2006, kohë kur nëna ime, shtetasja F.Z, na ka bërë me dije në lidhje me të drejtat që babai ynë i ndjerë kishte kundrejt shtetasit H.Sh, moment i cili përkonte me plotësimin e afatit 5-vjeçar të kthimit të huas nga ky shtetas, si dhe vendimmarrjes nga ana e saj për t’u shpërngulur nga qyteti i Fierit, ku jetonte, në kryeqytet”.

1.36 Ndërsa në lidhje me burimin e të ardhurave të babait të tij për krijimin e shumës 40,000 USD në vitin 2001, në përgjigje të këtij pyetësi subjekti ka deklaruar se babai i tij ka krijuar të ardhura ndër vite nga puna si teknik ndërtimi, kryesisht në shtetin grek, ku ka emigruar dhe punuar vazhdimisht duke filluar nga viti 1991 deri në vitin 2002. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti ka bashkëlidhur: (i) deklaratë përgjegjësie të shtetasit grek N. A (përkthyer dhe noterizuar), i cili deklaron se gjatë 3-vjeçarit, 1998 – 2001, z. T. Z ka punuar në shoqërinë “****” sh.a. si drejtor teknik dhe i pastrimit, me pagesë 180,000 DRH në muaj; (ii) deklaratë përgjegjësie e shtetasit grek E. P (përkthyer dhe noterizuar), i cili deklaron se gjatë 3-vjeçarit, 1993 – 1996, z. T. Z ka punuar në shoqërinë “****” sh.p.k. si teknik me pagesë ditore 8,000 DRH; (iii) vërtetim i vjetërsisë në punë nga Ministria e Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë, datë printimi 19.2.2024 (përkthyer dhe noterizuar), në të cilin vërtetohet se shtetasi T.Z është i siguar si punonjës për 263 ditë sigurim (nëntor 1995 – dhjetor 1996) tek punëdhënësi S.A.I; (iv) vërtetim i vjetërsisë në punë nga Ministria e Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë, datë printimi 19.2.2024 (përkthyer dhe noterizuar), në të cilin vërtetohet se shtetasi T.Z është i siguar si punonjës për 363 ditë sigurim (janar 1997 – mars 1998) tek punëdhënësi S.S.S IKE; (v) vërtetim i vjetërsisë në punë nga Ministria e Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë, datë printimi 19.2.2024 (përkthyer dhe noterizuar), në të cilin vërtetohet se shtetasi T.Z është i siguar si punonjës për 410 ditë sigurim (prill 1998 – dhjetor 1999) tek punëdhënësi S.S.S; (vi) deklaratë noteriale datë 5.3.2024 e shtetasve M.M dhe M. M, në të cilën deklarohet në vitet 1996 – 1998 kanë punuar në shtetin grek me shtetasin T.Z dhe paga ditore varionte nga 10,000 – 12,000 drahami.

1.37 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar: “Duke qenë se investimi i shumës 40,000 USD u përdor nga shoqëria, e cila nxori fitime prej saj, shoqëria “****” sh.p.k. ra dakord për shitjen e një apartamenti banimi në çmimin total 27,000 euro, shitje e cila u finalizua nëpërmjet kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.2013, lidhur përpara noterit N. I.

Nëse analizojmë pasqyrat financiare të shoqërisë “****” sh.p.k., të publikuara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), rezulton se ka pakësim të huas, deklaruar në Pasiv të bilancit, në zërin “Hua të tjera”. Në fund të vitit 2006, detyrimi ndaj huave ka qenë në shumën 15,318,445 lekë dhe në fund të vitit 2007 ka rezultuar të jetë në shumën 10,920,021 lekë, duke pasur një shlyerje të huas gjatë vitit 2007 në shumën 4,398,424 lekë, vlerë e cila është e barabartë me kthimin e vlerës së huas në 40,000 USD, duke mbajtur në konsideratë që kjo shumë është njohur në pasqyrat financiare me një kurs këmbimi mesatar nga USD në euro dhe në lek, prej 110 lekësh”.

1.38 Referuar dokumentacionit më sipër, Komisioni vlerësoi se subjekti ka arritur të provojë qëndrimin e babait të tij në shtetin grek, si dhe marrëdhëniet e punësimit, konkretisht vërtetuar me pagesë të sigurimeve për periudhën nëntor 1995 – dhjetor 1999 dhe me deklarata përgjegjësie të shtetasve grekë, të cilët pretendojnë punësim të tij për periudhën 1993 – 1996 dhe 1998 – 2001, të ardhura, paraqitur si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 3

Periudha	Përshkrimi	Të ardhura në DRH	Të ardhura në euro
1993 – 1996	Deklaratë përgjegjësie e shtetasit E.P	9,984,000	29,300
1998 – 6.2001	Deklaratë përgjegjësie e shtetasit N.A	7,560,000	22,186
	Totali	17,544,000	51,486

1.39 Nëse i referohemi këtij dokumentacioni, periudhave të punësimit, si dhe deklaramëve të ndryshme të të ardhurave për periudhën 1998 – 2001, në pamundësi të pasjes së një vlere të saktë të të ardhurave të përfituara nga babai i subjektit në shtetin grek për periudhën 1993 – qershor 2001, u mor në konsideratë periudha e dokumentimit nga sigurimet shoqërore greke dhe pagës së deklaruar nga shtetasit grekë për periudhën 1995 – 1999. Për sa i përket periudhave të tjera, një pjesë e shumës së pretenduar u vlerësua duke konsideruar edhe mbulimin për shpenzime të jetesës për periudhën objekt shqyrtimi.

1.40 Komisioni për periudhën e sigurimit (vërtetuar nga Ministria e Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë, nëntor 1995 – dhjetor 1999) ka përfshirë në llogaritje që babai i subjektit ka përfutuar rreth 180,000 DRH të ardhura në muaj. Për rrjedhojë, shuma e të ardhurave për këtë periudhë llogaritet në rreth 8,820,000 DRH (180,000 * 49 muaj) ose rreth 25,900 euro.

1.41 Gjithashtu, referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti për periudhën 1993 – tetor 1995, duket se të ardhurat e llogaritura janë në shumën 7,072,000 DRH (34 muaj * 8,000 DRH * 26 ditë/muaj). Për periudhën janar 2000 – qershor 2001 të ardhurat janë në vlerën 3,240,000 DRH (18 muaj * 180,000 DRH/muaj) dhe në total 19,132,000 DRH, konvertuar në 56,146 euro.

1.42 Nëse do të merrej në konsideratë edhe deklarimi i shtetasve M.M dhe M.M për shumat ditore të përfituara nga 10,000 – 12,000 DRH për periudhën 1996 – 1998, shuma e të ardhurave do të shtoheshin mesatarisht me vlerën 2,544,000 DRH⁷ ose rreth 7,500 euro, ndërsa shpenzimet për jetesë për një person në Greqi sipas të dhënave statistikore të Greqisë për periudhën 1994 – qershor 2001 llogariten rreth 24,500 euro.

1.43 Sa më sipër, Komisioni vlerëson se nga marrja në konsideratë e të dhënave të Ministrisë së Punës dhe Shërbimeve Shoqërore të Greqisë, si dhe deklaramet nën përgjegjësi të shtetasve grekë dhe deklarimit noterial të shtetasve shqiptarë, rezultoi se babai i subjektit ka pasur mundësi për krijimin e shumës 40,000 USD (konvertuar rreth 45,300 euro)⁸, të dhëna hua në qershor të vitit 2001 shtetasit H.Sh , duke e përfshirë këtë shumë në analizën paraprake financiare të Komisionit.

⁷ Llogaritet shtesë në shumën [(11,000 DRH/ditë * 26 ditë * 24 muaj) - (180,000 * 24 muaj)].

⁸ Konvertim kursi këmbimi në datën 31.12.2001 (referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë).

Analizë e burimit të të ardhurave për pagesën e këstit të tretë të çmimit të blerjes së këtij apartamenti

1.44 Në lidhje me pagesën e këstit të tretë të çmimit të blerjes së këtij apartamenti, subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. *** ka deklaruar se: “...Në mandatarkëtimin e lëshuar nga shoqëria “*** ” sh.p.k., në datën 24.5.2015, konstatohet pagesa e vlerës prej 4,130 euro, e cila përbën pagesën e pjesshme të vlerës së mbetur prej 5,000 euro, në kushtet kur sipërmarrësi kishte realizuar punimet sipas dakordësisë, duke u zbritur nga ajo vlerë shuma 870 euro, e cila përfaqësonte vlerën e 5 dyerve të brendshme dhe 2 kompleteve hidrosanitare, të cilat ishin vendosur nga ana ime.

*Burimi i të ardhurave për vlerën prej 4,130 euro ka qenë shitja e automjetit tip “***” në vitin 2014, të cilat ishin gjendje cash dhe kursime familjare”.*

1.45 Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 24.5.2015, për blerje pasurie në shumën 84,000 euro, nga të cilat shuma 79,000 euro, paguar në vitin 2012, kurse 5,000 euro të paguara nga kursimet e pagave vitet e fundit.

i. Të ardhura nga shitja e automjetit tip “”***

1.46 Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit në seksionin e ndryshimit të pasurive dhe burimit e krijimit ka deklaruar ndër të tjera edhe shitje automjeti tip “***” në shumën 4,000 euro, në emër të bashkëshortes, blerë në vitin 2012. Në bazë të kontratës së shitjes të automjetit, datë 2.10.2014, znj. S.Z ka shitur automjetin tip “***”, me targë AA***, për çmimin 4,000 euro, të likuiduar.

1.47 Nisur nga fakti që në pyetësorin nr. *** subjekti ka deklaruar se kjo shumë u është shtuar likuiditeteve *cash*, si dhe në deklaratën e interesave privatë për vitin 2014 ka deklaruar të kursyera nga të ardhurat nga pagat vjetore shumën 400,000 lekë, Komisioni ka vlerësuar që shuma e gjendjes *cash* në këtë vit të jetë 400,000 lekë, analizuar në pikën (ii), si vijon.

ii. Kursime familjare gjendje cash

1.48 Referuar DIPPV-ve, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këto gjendje të kursimeve *cash*, konkretisht: në DIPPV-në e vitit 2012 nuk ka deklaruar kursime *cash*; në DIPPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar shumën prej 600,000 lekësh, të kursyer nga të ardhurat nga pagat vjetore; në DIPPV-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të kursyer nga të ardhurat nga pagat vjetore shumën 400,000 lekë.

1.49 Sa më sipër, referuar deklarimeve të subjektit, shuma e likuiditeteve *cash* të akumuluarra deri në datën 1.1.2015 rezulton 1,000,000 lekë.

1.50 Referuar analizës paraprake të kryer nga Komisioni për vitet 2013 – 2014, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur (bashkëshortja) kanë pasur burime të ardhurash për të justifikuar kursimet e mundshme *cash*, të deklaruara në DIPPV-të përkatëse.

1.51 Nisur nga fakti që në deklaratën e interesave privatë për vitin 2015 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe kursim nga paga vjetore shumë 100,000 lekë, Komisioni kreu një analizë financiare për vitin 2015, për të evidentuar mundësinë e subjektit dhe personit të lidhur për pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit, krijim të kursimeve të deklaruara, si dhe kryerje të shpenzimeve të deklaruara dhe të llogaritura, konkretisht:

Tabela nr. 4

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2015 – 31.12.2015	
Përshkrimi	Vlera në lek
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit subjekti dokumentuar për periudhën	1073870
Të ardhurat nga marrëdhëniet e punësimit, bashkëshortja, për periudhën	0
Të ardhura të tjera, interesa	5160
Total të ardhura/të hyra financiare	1079030
Shpenzim për pagesë të kësteve të blerjes së apartamentit në shumë 5,000 euro	686400
Shpenzime për udhëtim dhe qëndrim jashtë vendit për periudhën	133162
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën	897104
Total shpenzime/të dala financiare	1716666
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim – gj. fund periudhe	586400
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim – gj. fund periudhe	-106932
Mjete monetare të disponueshme	-158168

1.52 Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur pamundësi financiare për pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit dhe garazheve, shtesën në likuiditet, si dhe kryerje të shpenzimeve në atë vit në vlerën prej 158,168 lekësh.

1.53 Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e tij për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit në lidhje me pamundësinë prej -151,168 lekësh, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.54 Në përgjigje të rezultateve të hetimit në lidhje me këtë pamundësi financiare të konstatuar nga Komisioni për vitin 2015, subjekti i ka kërkuar Komisionit të vlerësojë këtë moment në kuadër të parimeve të ligjit nr. 84/2016, konkretisht sipas parimit të proporcionalitetit, referuar neneve 4 dhe 52⁹ të këtij ligji.

⁹ Neni 4

Objekti dhe parimet e procesit të rivlerësimit

5. Komisioni dhe Kolegji i Apelit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

Neni 52

Barra e provës

1. Komisioni dhe Kolegji i Apelit në shqyrtimin e çështjes udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit.

Vlerësimi i Komisionit

1.55 Komisioni, duke iu referuar analizës financiare si dhe shpjegimeve të subjektit, doli në përfundimin se subjekti dhe personat e lidhur kishin një pamundësi financiare prej -158,167 lekësh për blerjen e pasurisë apartament dhe 2 garazhe, në vlerën 84,000 euro.

1.56 Komisioni vendosi që kjo mungesë e burimeve financiare të ligjshme në vlerën prej -158,167 lekësh nuk mund të ndikojë në vlerësimin përfundimtar të subjektit në lidhje me këtë pasuri.

1.57 Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti ka bërë deklaram të saktë dhe të mjaftueshëm për të justifikuar blerjen e pasurisë apartament dhe garazhe në vlerën 84,000 euro së bashku, në vitin 2015, sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

2. Apartament në Vlorë

2.1 Subjekti ka deklaruar apartament në qytetin e Vlorës me nr. pasurie ***, blerë me kontratën nr. ***, datë 20.9.2013, në shumën 27,000 euro. Zotëron: 50%.

2.2 Sipas deklaramit të subjektit, burimi i të ardhurave të kësaj pasurie rrjedh nga marrëveshja e arritur me shtetasin H.Sh si administrator i shoqërisë “*** ” sh.p.k., i cili i ka marrë babait në formë huaje shumën 40,000 USD në vitin 2001 dhe ka kthyer në vitin 2007 shumën prej 40,000 euro dhe apartamentin e sipërpërmendur, vërtetuar me deklaratën noteriale nr. ***.

Hetimi i Komisionit

2.3 Bazuar në certifikatën për vërtetim pronësie nr. ***, datë 5.11.2013, apartamenti me sip. 78 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, në qytetin e Vlorës, rezulton në pronësi të subjektit Aurel Zarka.

2.4 Rezultoi se me kontratë shitjeje nr. ***, datë 20.9.2013, subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka ka blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. pasurinë apartament me sipërfaqe 78 m². Kjo pasuri ka qenë e regjistruar dhe ka pasur certifikatë pronësie nr. ***, datë 18.3.2013, në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

2.5 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar këtë pasuri në pjesë 50%, blerë me kontratën nr. ***, datë 20.9.2013, në shumën 27,000 euro. Burimi i të ardhurave të kësaj pasurie rrjedh nga marrëveshja e arritur me shtetasin H.Sh si administrator i shoqërisë “**** ” sh.p.k., i cili i ka marrë babait të subjektit në formë huaje shumën prej 40,000 USD në vitin 2001, dhe i ka kthyer subjektit në vitin 2007 shumën 40,000 euro dhe apartamentin e sipërpërmendur, vërtetuar me deklaratën noteriale nr. ***, viti 2001.

2.6 Në bazë të kontratës së huas të datës 26.6.2001, shtetasit H.Sh dhe T.Z kanë rënë dakord që dhënia e shumës 40,000 USD nga z. Zarka të jetë për një periudhë 5-vjeçare dhe, në mbarim të këtij afati, shtetasi H.Sh , përveç shumës së marrë hua, detyrohet t’i japë z. Zarka edhe një apartament banimi në qytetin e Vlorës jo më të vogël se 60 m².

2.7 Për pasurinë apartament është lidhur fillimisht një kontratë kapari, nr. ***, datë 1.11.2007, me palë shitëse të ardhshme shoqërinë “**** ” sh.p.k. dhe palë blerëse të ardhshme z. Aurel Zarka. Sipas kësaj kontrate, shoqëria “****” sh.p.k. ka nisur punimet për ndërtimin e një kulle 8-9 kate sipas lejes së miratuar nga Bashkia Vlorë. Sipas vendimit nr. ***, datë 16.6.2006, të KRRT-së Vlorë, dhe vendimit nr. ***, datë 15.9.2006, të KRRT-së Bashkia Vlorë, shoqëria

“****” sh.p.k. është pajisur me leje ndërtimi për ndërtim objekti 8 - 9 kate në lagjen “****”, Vlorë.

2.8 Sipas kësaj marrëveshjeje kapari, palët kanë rënë dakord që pala blerëse e ardhshme të blejë prej shoqërisë “**** ” sh.p.k. në seksionin *** apartament të tipit ***, në katin e parë teknik, me sipërfaqe totale 86.6 m², kundrejt çmimit 28,800 euro, duke rënë dakord që ky çmim të likuidohet, konkretisht brenda datës 5.11.2007 pala blerëse e ardhshme duhet të likuidojë shumën 23,000 euro dhe shuma 5,800 euro të likuidohet në momentin e dorëzimit të apartamentit me çelësa në dorë. Siç duket, kjo kontratë kapari nuk është finalizuar nga palët.

2.9 Më pas, subjekti duket se ka përfituar fillimisht një apartament në të njëjtin objekt ndërtimor në lagjen “****”, Vlorë, me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, që është blerë nga ai kundrejt çmimit 27,000 euro, shumë e likuiduar nga shoqëria “**** ” sh.p.k. me kliring. Për këtë pasuri të paluajtshme, apartament me sip. 78 m², është lëshuar edhe një certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 26.9.2013, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, Vlorë, në pronësi të subjektit Aurel Zarka.

2.10 Në fund, subjekti ka lidhur edhe një kontratë shkëmbimi nr. ***, datë 29.10.2013, me shoqërinë “****” sh.p.k., pronare e pasurisë nr. ***, dhe atij si pronar i pasurisë nr. *** në lagjen “****”, Vlorë. Sipas kësaj kontrate, palët shkëmbejnë pasuritë respektive: Aurel Zarka bëhet pronar i pasurisë me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, z. k. ***, lagjja “****”, Vlorë, ndërsa shoqëria “****” sh.p.k. pronare e pasurisë tjetër.

Deklarimet e subjektit ndër vite për këtë pasuri apartament

2.11 Në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës në vitin 2012, subjekti i rivlerësimit në seksionin “Deklarim i interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme” ka deklaruar apartament banimi me sip. 84 m² pranë ***, Vlorë, blerë në vitin 2007, në shumën 29,400 euro (me kontratë sipërmarrje, pa hipotekë), me burim “të ardhurat familjare ndër vite”. Në këtë deklaram, subjekti ka pasqyruar si adresë vendqëndrim tjetër, jo këtë pasuri.

2.12 Edhe në DIPPV-në e vitit 2012 është bërë i njëjti deklaram për këtë pasuri, gjendjen e saj, çmimin dhe burimin e krijimit.

2.13 Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë pasuri, duke evidentuar marrjen e certifikatës së pronësisë.

2.14 Në lidhje me këtë pasuri është pyetur subjekti për të shpjeguar:

- diferencat në çmimet e deklaruara;
- nëse nga trashëgimtarët e tjerë ligjorë të babait (nëna dhe motra) ka pasur shprehje vullneti lidhur me përfitimin nga subjekti të interesave të huas dhënë nga babai në vitin 2001;
- kohën në të cilën është marrë në dorëzim dhe kur ka filluar qëndrimin në këtë apartament;
- nëse nga ana e subjektit janë kryer investime shtesë për këtë pasuri dhe/ose shpenzime mobili.

2.15 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar: *“Sqaroj se ndryshimi në çmim vjen për shkak të faktit se sipërfaqja e banimit e kontraktuar në vitin 2007 ishte më e madhe (84 m²) sesa sipërfaqja e banimit e kontraktuar përfundimisht në vitin 2013 prej 78 m² sipas certifikatës së pronësisë përkatëse.*

*Me anë të deklaratës noteriale nr. ***, datë 21.8.2006, e lëshuar nga trashëgimtarët e shtetasit T.Z, shtetasit F, M dhe Aurel Zarka, trashëgimtarët e të ndjerit T.Z, nëna ime F.Z, unë dhe motra ime M.Z kemi deklaruar se: “Duke qenë se huaja dhe interesat, lindur nga të drejtat e trashëgimlënësit tonë, të ndjerit T.Z, ende nuk janë kthyer nga huamarrësi, autorizojmë djalin dhe vëllain tonë, shtetasin Aurel T Zarka, që në lidhje me këto të drejta dhe detyrime të shtetasit H.Sh që rrjedhin nga marrëdhënia e huamarrjes, të përdorë shumën e dhënë hua nga i ndjeri, duke pasur të drejtë ta arkëtojë atë dhe interesat përkatës, si dhe të përdorë lirisht e pa kufizim të gjitha të drejtat që mund të vijnë nga kjo huadhënie”. Me këtë deklaratë është dhënë dakordësia nga nëna dhe motra ime që interesat e huas së dhënë nga babai, shtetasi T. Z, tek huamarrësi H.Sh , të përfaqësuara nga apartamenti 1+1 në qytetin e Vlorës, të përfitoheshin prej meje, duke u disponuar ato lirisht nga unë.*

Apartamenti është marrë në dorëzim në fund të vitit 2011 dhe qëndrimi në të ka filluar me marrjen e detyrës, në muajin qershor 2012.

Në këtë pasuri nuk kam kryer investime shitesë, përveç shpenzimeve për mobilimin e saj. Shpenzimet e mobilimit janë kryer në vitet 2011 dhe fillimin e 2012. Vlera e investuar ka qenë përafërsisht 300,000 lekë”.

2.16 Komisioni konstatoi se duket se ka një mospërputhje në çmim të deklaruar për këtë pasuri, pasi në deklaratën *Vetting* dhe në kontratën e shitjes së datës 20.9.2013 çmimi është 27,000 euro, ndërsa në deklarimin periodik vjetor është 29,400 euro dhe në kontratën e kaparit çmimi është 28,800 euro.

2.17 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: “...ndryshimi në çmim vjen për shkak të faktit se sipërfaqja e banimit e kontraktuar në vitin 2007 ishte më e madhe (84 m²) sesa sipërfaqja e banimit e kontraktuar përfundimisht në vitin 2013, prej 78 m², sipas certifikatës së pronësisë përkatëse...”.

2.18 Bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 28.2.2024, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të ketë hetuar shtetasin F.L, F.L , ose shoqërinë “***” dhe “****” sh.p.k.

Analizë e burimit të të ardhurave për blerje të kësaj pasurie dhe mundësia financiare

2.19 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim krijimi që rrjedh nga marrëveshja e arritur me shtetasin H.Sh si administrator i shoqërisë “*** ” sh.p.k., i cili i ka marrë babait të subjektit shumën prej 40,000 USD në vitin 2001 dhe i ka kthyer subjektit shumën prej 40,000 euro dhe apartamentin e sipërpërmendur, vërtetuar me deklaratën noteriale nr. ***.

2.20 Në kontratën e shitjes datë 20.9.2013, në lidhje me pagesën e çmimit të shitjes së apartamentit, pala shitëse, shoqëria “****” sh.p.k. dhe z. Aurel Zarka kanë rënë dakord që çmimi prej 27,000 euro i blerjes së apartamentit me sip. 78 m² në Vlorë të likuidohet nga shoqëria “*** ” sh.p.k. me kliring.

2.21 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar ndër të tjera se: *“Sikurse rezulton, çmimi prej 27,000 euro si vlerë përfundimtare e blerjes së apartamentit është paguar nga shoqëria “*** ” sh.p.k, ndërsa unë në cilësinë e blerësit në momentin e porositjes nuk kam bërë asnjë pagesë, sikurse është përcaktuar dhe në kontratën e huas me administratorin e shoqërisë...”*.

2.22 Komisioni pyeti subjektin e rivlerësimit për pagimin e tatimit lidhur me përfitimin e kësaj pasurie apartament.

2.23 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar: *“Nëpërmjet kontratës së huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.6.2001, lidhur përpara noterit A.M., midis palëve H. Sh dhe babait T. Z është përcaktuar se nga shuma 40,000 USD, që babai i dha hua shtetasit H.Sh për një periudhë 5-vjeçare, do të përfitonte si interes mbi shumën e dhënë hua edhe një apartament me sipërfaqe jo më të vogël se 60 m². Shtetasi H.Sh ka qenë në cilësinë e administratorit dhe ortak në shoqërinë “*** ” sh.p.k.*

*Me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.9.2013, lidhur përpara noterit N. I, me palë shitëse shoqërinë “***” sh.p.k. është përcaktuar se çmimi total prej 27,000 euro është likuiduar nga shoqëria “*** ” sh.p.k. me kliring.*

*Sikurse rezulton, çmimi prej 27,000 euro, si vlerë përfundimtare e blerjes së apartamentit është paguar nga shoqëria “*** ” sh.p.k., ndërsa unë në cilësinë e blerësit në momentin e porositjes nuk kam bërë asnjë pagesë, pasi me administratorin e shoqërisë, sikurse është përcaktuar edhe në kontratën e huas, është rënë dakord që vlera e apartamentit do të përfaqësojë shumën e interesave të përfituar nga dhënia e huas në vlerën 40,000 USD.*

*Me shkresën nr. *** prot., datë 9.5.2024, Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë ka kthyer përgjigje, duke argumentuar se: “Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, përcakton parimin e mbajtjes në burim të tatimit për tatimpaguesit që nuk janë të regjistruar në administratën tatimore.*

Ky parim është i përcaktuar në disa nene të këtij ligji për disa nga kategoritë e të ardhurave personale, të cilat janë të përcaktuara në nenin 8 “E ardhura e tatueshme”. Konkretisht, në nenin 10 “Mbledhja e tatimit” për të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës; Neni 11 “Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”; Neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”.

Në pikën 1 të nenit 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat” janë përcaktuar kategoritë e të ardhurave, për të cilat mbahet tatim në burim për pagesat e kryera nga personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore e vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër i njohur nga legjislacioni në fuqi. Kategoritë e të ardhurave për të cilat mbahet tatim në burim në zbatim të këtij neni janë: ...a) interesat dhe pagesat e ngjashme me to.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, huamarrësi llogarit, mban dhe paguan në administratën tatimore tatimin për pagesën e interesave”.

Nga sa më lart, theksojmë se të ardhurat nga interesat kanë të njëjtën natyrë, sikurse janë të ardhurat nga qiraja. Detyrimi për pagesën e tatimit në burim nga të ardhurat nga qiraja është përcaktuar në nenin 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i

ndryshuar. E njëjta dispozitë zbatohet edhe në rastet e të ardhurave nga interesat, ashtu siç konfirmohet edhe nga vetë autoriteti tatimor në përgjigjen e tij.

Trupat e rivlerësimit kanë tashmë një qëndrim të konsoliduar në lidhje me personin që mbart detyrimin për pagesën e tatimit në burim. Sikurse rezulton në rastet e të ardhurave nga qiraja, personi që mbart detyrimin është tatimpaguesi i regjistruar në organet tatimore nëse ai është në cilësinë e qiramarrësit, i njëjti trajtim vlen dhe për të ardhurat nga interesat, që është huamarrësi personi që mbart detyrimin për pagesën e tatimit në burim.

*Pagesa e interesit është kryer nga shoqëria “*** ” sh.p.k., e cila shumën e interesave të huas dhënë nga babai nuk e ka likuiduar në të holla, por në natyrë, duke dhënë apartamentin për të cilin është lidhur kontrata e porosisë në vitin 2007”.*

Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti ka referuar për analogji edhe vendime të Kolegjit dhe një vendim të Komisionit¹⁰.

2.24 Sa më sipër, Komisioni, mbështetur në burimin e të ardhurave të deklaruar në deklaratën *Vetting*, ku si burim për krijimin e kësaj pasurie subjekti i është referuar deklaratës noteriale nr. ***, ka vlerësuar që kjo pasuri të pasqyrohet në analizën paraprake financiare, e blerë nga subjekti në shumën 27,000 euro, paguar në datën 5.11.2007 shuma 23,000 euro dhe në vitin 2011 shuma 4,000 euro, ndërsa si burim të merren në bazë të kontratës së huas të datës 26.6.2001 përcaktimet në kontratën e shitjes të datës 20.9.2013, ku *çmimi prej 27,000 euro i blerjes së apartamentit me sip. 78 m² në Vlorë është likuiduar nga shoqëria “*** ” sh.p.k. me kliring dhe deklarata noteriale nr. ***, datë 16.6.2016, e shtetasit H.Sh (sa më sipër analizuar).*

2.25 Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni ka pasqyruar të dhënat në analizën financiare për periudhën deri në datën 6.6.2012.

2.26 Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

3. Automjet tip “*”**

3.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar këtë pasuri në pjesën 100%, të blerë në shumën 100,000 lekë, me kontratën nr. *** dhe si burim të ardhurash ka deklaruar kursimet nga pagat.

3.2 Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2013, në ndryshim të pasurive dhe burimin e krijimit, subjekti ka deklaruar ndër të tjera edhe *automjet “***”, vit prodhimi 2002, blerë në shumën 100,000 lekë, me burim të ardhura të kursyera nga pagat vjetore.*

3.3 Me kontratë shitjeje pasurie të luajtshme nr. ***, datë 24.10.2013, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi A. P (1946) automjetin tip “***”, me targë AA ***, vit prodhimi 2002, kundrejt çmimit 100,000 lekë (shumë e paguar jashtë zyrës noteriale pa pretendime).

¹⁰ Shihni përgjigjen e subjektit mbi pyetësin nr. ***.

3.4 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se *gjatë vitit 2012 ka përdorur për një periudhë 15-ditore, nga data 1.8.2012 deri në datën 16.8.2012, mjetin me targë AA *** në pronësi të shtetasit A.P, me qëllim udhëtimi në Greqi.*

Analizë e burimit të të ardhurave për blerje të kësaj pasurie dhe mundësia financiare

3.5 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurash kursimet nga pagat, ndërsa në deklaratën e interesave private për vitin 2013 burimi është përcaktuar nga të ardhura të kursyera nga pagat vjetore.

3.6 Nisur nga fakti që në DIPPV-në e vitit 2013 subjekti ka deklaruar shumën prej 600,000 lekësh si kursime nga të ardhurat, Komisioni kreu një analizë paraprake financiare për vitin e mbyllur 2013, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personave të lidhur për krijim pasurish dhe kryerje të shpenzimeve në këtë vit, konkretisht:

Tabela nr. 5

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2013 – 31.12.2013	
Përshkrimi	Vlera në lek
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit, subjekti dokumentuar për periudhën	841446
Të ardhurat nga marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortes për periudhën	646753
Të ardhura përfitime nga leje lindja bashkëshortja sipas ProCredit dhe Union Bank	81480
Transferuar në llogari të bashkëshortes nga L. E., datë 9.8.2013	2103000
Të ardhura të tjera, interesa	108697
Total të ardhura/të hyra financiare	3781376
Shpenzim blerje autoveture datë 24.10.2013	100000
Shpenzime për udhëtim dhe qëndrim jashtë vendit për periudhën	150715
Shpenzime shëndetësore, deklaruar	322460
Shpenzim interesa bankarë të paguar (sistemim i interesave kreditorë nga likuiditetet e shtetasit L. E)	34060
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën	453209
Total shpenzime/të dala financiare	1060444
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar gj. fillim – gj. fund periudhe	-600000
Ndryshim mj. monetare bankë dokumentuar gj. fillim – gj. fund periudhe	-1373862
Mjete monetare të disponueshme	747,070

3.7 Sa më sipër, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur burime të ardhurash për blerjen e automjetit, krijimin e gjendjeve *cash*, shtesat në llogari bankare dhe kryerje të shpenzimeve në vitin 2013.

3.8 Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika në lidhje me këtë pasuri.

4. Llogari rrjedhëse pranë Credins Bank në shumën 259,037 lekë

4.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar këtë gjendje në llogari bankare në datën 23.1.2017 (në pjesë 100%), të krijuar nga të ardhurat nga pagat.

4.2 Referuar të dhënave nga Credins Bank me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.10.2021, rezulton se kjo llogari e pagës së subjektit është hapur në janar të vitit 2010, në të cilën janë transferuar pagat si OPGJ në Prokurorinë për Krimet e Rënda dhe më pas nga Prokuroria e Rrethit Vlorë.

4.3 Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 rezultoi 216,320 lekë, ndërsa në datën 23.1.2017 gjendja e saj rezulton në shumën 258,436 lekë.

4.4 Në lidhje me burimin e të ardhurave të kësaj gjendjeje, ajo vjen si rezultat i transferimit të pagave për shkak të funksionit të subjektit, ndërsa për sa i përket mundësisë financiare shumë gjendje në fund të vitit në këtë llogari janë pasqyruar në analizën financiare, pjesë e këtij vendimi.

4.5 Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

5. Llogari rrjedhëse pranë Raiffeisen Bank në shumën 388,929 lekë

5.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar këtë gjendje në llogari bankare në datën 24.1.2017 (në pjesë 100%), të krijuar nga të ardhurat nga pagat dhe interesat e përfituar në këtë bankë.

5.2 Kjo është një llogari e hapur në vitin 2005, ndërsa për periudhën 2011 – 2016 ka pasur këtë gjendje në llogari, paraqitur si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 6

Viti	Gjendje në datën 31 dhjetor (në lek)
2011	600227
2012	201075
2013	207042
2014	176908
2015	391046
2016	390929

5.3 Këto shuma janë pasqyruar në analizën financiare të Komisionit dhe ka rezultuar që subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e tyre.

5.4 Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

6. Llogari rrjedhëse e bashkëshortes pranë Credins Bank në shumën 97,027 lekë

6.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar këtë gjendje në llogari bankare në emër të bashkëshortes në datën 25.1.2017 (në pjesë 100%), të krijuar nga të ardhurat nga paga.

6.2 Referuar të dhënave nga Credins Bank me shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.10.2021, rezulton se kjo llogari e pagës së personit të lidhur (bashkëshortes së subjektit) është hapur në dhjetor 2016, në të cilën janë transferuar pagat nga Bashkia Tiranë.

6.3 Gjendje në këtë llogari në datën 31.12.2016 rezulton shuma 39,309 lekë, ndërsa në datën 25.1.2017 gjendja e saj është 97,027 lekë.

6.4 Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

7. Llogari rrjedhëse e bashkëshortes pranë Union Bank në shumën 418,341 lekë

7.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar këtë gjendje në llogari bankare në emër të bashkëshortes në datën 26.1.2017 (në pjesë 100%), të krijuar nga të ardhurat nga paga.

7.2 Referuar të dhënave nga Union Bank me shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 6.10.2021, rezulton se kjo llogari e pagës së personit të lidhur (bashkëshortes së subjektit) është hapur në shtator 2011, në të cilën janë transferuar pagat nga shoqëria “****” deri në vitin 2014, gjithashtu edhe përfitime nga sigurimet shoqërore për periudhën nëntor 2013 – korrik 2014.

Tabela nr. 7

Viti	Gjendje në datën 31 dhjetor (në lek)
2011	209881
2012	278002
2013	218910
2014	465928
2015	417047
2016	417982

7.3 Gjendje në këtë llogari në datën 31.12.2016 rezulton shuma 417,982 lekë, ndërsa në datën 26.1.2017 gjendja e saj është 418,341 lekë.

7.4 Në lidhje me mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për kursim/shtim të gjendjes në këtë llogari, këto likuiditete janë pasqyruar më poshtë në analizën financiare.

7.5 Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika në lidhje me këtë llogari bankare.

8. Fond investimi pranë Raiffeisen Invest në vlerën 9,118,267 lekë

8.1 Subjekti e ka deklaruar në deklaratën *Vetting* këtë fond investimi të krijuar në datën 29.1.2013.

8.2 Si burim të ardhurash subjekti ka renditur:

- shitje sipërfaqe toke me kontratën datë 7.9.2004, në shumën 1,500,000 lekë;
- shitje sipërfaqe toke me kontratën datë 18.9.2006, në shumën 2,000,000 lekë;
- shitje shtëpie në Fier me kontratën datë 14.10.2006, në shumën 1,900,000 lekë;
- shitje shtëpie në Tiranë, në shumën 4,318,800 lekë;
- shitje sipërfaqe toke me kontratën nr. ***, në shumën 227,000 lekë;
- shitje sipërfaqe toke me kontratën nr. ***, në shumën 227,000 lekë;
- shitje sipërfaqe toke me kontratën nr. ***, në shumën 340,000 lekë.

8.3 Subjekti ka paraqitur në dosjen *Vetting* (nr. ***)¹¹ edhe vërtetimin nr. ***, datë 26.1.2017, të Raiffeisen Invest (për periudhën 1.3.2015 – 24.1.2017), në të cilin rezulton se vlera e kuotave në datën 24.1.2017 është 9,118,267 lekë.

8.4 Në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës në vitin 2012, me datë dorëzimi 1.10.2012, në deklarim të interesave privatë pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme, subjekti ndër të tjera ka deklaruar: “...llogari bankare në emër të tij në shumën 7,500,000 lekë në Raiffeisen Bank, me burim kryesor shitje pasuri të patundshme të familjes (toka dhe shtëpia në Fier, për shumën 6,000,000 lekë), si dhe një shtëpi në Tiranë blerë në vitin 2006 në shumën 2,000,000 lekë dhe shitur në vitin 2008 në shumën 4,300,000 lekë...”.

¹¹ Faqja *** e dosjes *Vetting*, e skanuar.

8.5 Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar edhe llogari bankare në emër të tij në Raiffeisen Bank, në shumën 8,175,000 lekë, me burim kryesor shitje pasuri të patundshme të familjes (toka dhe shtëpia në Fier për shumën 6,000,000 lekë), si dhe një shtëpi në Tiranë blerë në vitin 2006 në shumën 2,000,000 lekë dhe shitur në vitin 2008 në shumën 4,300,000 lekë + interesa bankarë.

8.6 Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndër të tjera llogari bankare në Raiffeisen Bank në emër të tij, në shumën 8,400,000 lekë, me burim kryesor shitje pasuri të patundshme të familjes (toka dhe shtëpia në Fier për shumën 6,000,000 lekë), si dhe një shtëpi në Tiranë blerë në vitin 2006 në shumën 2,000,000 lekë dhe shitur në vitin 2008 (dokumentet e paraqitura pranë ILDKPKI-së në vitin paraardhës) në shumën 4,300,000 lekë + interesa bankarë për vitin 2014.

8.7 Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogari bankare në Raiffeisen Bank në emër të tij, në shumën 8,500,000 lekë, deklaruar më parë, me burim kryesor shitje pasuri të patundshme të familjes (toka dhe shtëpia në Fier për shumën 6,000,000 lekë), si dhe një shtëpi në Tiranë blerë në vitin 2006 në shumën 2,000,000 lekë dhe shitur në vitin 2008 (dokumentet e paraqitura pranë ILDKPKI-së në vitin paraardhës) në shumën 4,300,000 lekë + interesa bankarë për vitin 2015.

8.8 Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogari bankare në Raiffeisen Bank në emër të tij, në shumën 9,106,000 lekë, deklaruar më parë, me burim kryesor shitje pasurish të patundshme të familjes (toka dhe shtëpia në Fier për shumën 6,000,000 lekë), si dhe një shtëpi në Tiranë blerë në vitin 2006 në shumën 2,000,000 lekë dhe shitur në vitin 2008 (dokumentet e paraqitura pranë ILDKPKI-së në vitin paraardhës) në shumën 4,300,000 lekë + interesa bankarë për vitin 2016.

8.9 Raiffeisen Invest, me shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 24.9.2021, informon se subjekti i rivlerësimit:

- në datën 29.1.2013 ka blerë kuota për shumën 5,000,000 lekë;
- në datën 9.2.2015 ka blerë kuota për shumën 319,000 lekë;
- në datën 4.3.2015 ka blerë kuota për shumën 2,000,000 lekë.

8.10 Sa më sipër, deri në datën 27.1.2017, në këtë shoqëri investimi janë investuar 7,319,000 lekë, ndërsa vlera e kuotave në datën 24.1.2017 ka qenë 9,118,267 lekë.

8.11 Në vlerësim të faktit se shuma e interesit të përfitur nga ky investim llogaritet në momentin e shitjes së kuotave, nga të cilat deri në datën 27.1.2017 nuk është shitur asnjë, në analizën financiare janë pasqyruar vetëm shumat e investuara nga subjekti për periudhën 2013 – 2016.

Analiza e burimit të të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie dhe mundësia financiare

8.12 Si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në deklarimin e interesave privatë para fillimit të detyrës dhe atyre periodike vjetore 2012 – 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të ardhurat nga shitja e pasurive të paluajtshme të familjes, tokë dhe shtëpi në Fier, në shumën 6,000,000 lekë, si dhe një shtëpi në Tiranë blerë në shumën 2,000,000 lekë dhe shitur në vlerën 4,300,000 lekë, në vitin 2008.

8.13 Komisioni, për të vlerësuar burimin e deklaruar të të ardhurave për krijimin e këtyre likuiditeteve, analizoi çdo burim të deklaruar nga subjekti, konkretisht:

a. Të ardhurat nga shitja e një sipërfaqeje toke me kontratën datë 7.9.2004, në shumën 1,500,000 lekë

Për këtë pasuri rezultoi kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 7.9.2004, ku shtetasit Aurel, F dhe M.Z shesin tokë me sip. 1.000 m², z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, ***, Fier, kundrejt çmimit 1,500,000 lekë.

b. Të ardhurat nga shitja e një sipërfaqeje toke me kontratën datë 18.9.2006, në shumën 2,000,000 lekë

Referuar të dhënave nga Raiffeisen Bank rezulton se në datën 18.9.2006 janë depozituar *cash* nga subjekti 2,000,000 lekë dhe në datën 13.11.2006 është tërhequr *cash* kjo shumë.

Për këtë pasuri rezultoi kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 18.9.2006, ku shtetasit A, F dhe M.Z shesin tokë me sip. 1.000 m², z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, ***, Fier, kundrejt çmimit 2,000,000 lekë.

c. Të ardhurat nga shitja e shtëpisë në Fier, me kontratën datë 14.10.2006, në shumën 1,900,000 lekë

Për këtë pasuri rezultoi kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 14.10.2006, sipas së cilës shtetasit A, F dhe M.Z shesin truall me sip. 200 m², nga i cili ndërtesë me sip. 74 m², z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, ***, Fier, kundrejt çmimit 1,900,000 lekë.

d. Të ardhurat nga shitja e shtëpisë në Tiranë, në shumën 4,318,800 lekë

Lidhur me këtë pasuri, rezultoi se me anë të kontratës datë 31.10.2008 është shitur apartamenti i banimit me sip. 59 m², blv. “****”, Tiranë, në pronësi të subjektit, në shumën 4,318,800 lekë.

Në bazë të të dhënave nga ASHK Tirana Jug¹² rezulton se pasuria e llojit apartament me sip. 59 m², blv. “****”, Tiranë, është e regjistruar në datën 8.3.2014 në emër të shtetasve A. P. dhe M. P., blerë me kontratë shitjeje nr. ***, datë 31.10.2008.

Referuar të dhënave nga Raiffeisen Bank rezulton se në datën 7.11.2008 është depozituar *cash* nga subjekti në llogarinë në emër të tij në këtë bankë shuma 5,000,000 lekë, me përshkrimin “Derdhje në llogari nga shitja e apartamentit”. Në të njëjtën datë ka hyrë në depozitë me afat shuma 5,000,000 lekë. Kthim në datën 7.5.2009 në shumën 5,128,311 lekë dhe rifutje të shumës 5,000,000 lekë. Ndërsa me mandatin e datës 10.11.2008 të Credins Bank, subjekti i rivlerësimit ka paguar tatimin prej 214,100 lekësh.

Në lidhje me përfitimin e kësaj pasurie

Në dosjen *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur kontratën e shitjes (pasuri të paluajtshme) nr. ***, datë 13.1.2007, nëpërmjet së cilës shtetasi N. I i shet subjektit pasurinë e paluajtshme apartament banimi në blv. “****”, pallati ***, shkalla ***, kati ***, apartamenti ***, me sip. 59 m², në Tiranë, kundrejt çmimit 2,000,000 lekë (likuidim i kryer jashtë zyrës noteriale).

¹² Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.10.2021.

Sa më sipër, duket se ka mospërputhje të kohës së blerjes së kësaj pasurie, pasi në deklarimet periodike vjetore është vendosur viti 2006, ndërsa sipas kontratës kjo pasuri është blerë në datën 12.1.2007.

Në përgjigje të pyetësorit nr. *** në lidhje me diferencën e çmimit të blerjes nga ai i shitjes së këtij apartamenti, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar se: *“...blerja e apartamentit nga shtetasi N.I është bërë në kushtet kur unë nuk kam pasur asnjëherë ndonjë çështje të ndjekur apo hetuar në ngarkim të tij, aq më pak në atë periudhë nuk ushtroja detyrën e prokurorit, por atë të oficerit të policisë gjyqësore. Madje nuk kam asnjë njohje me këtë shtetas. Ky çmim është dakordësuar prej shitësit për shkak se në atë periudhë poshtë këtij apartamenti ushtronte aktivitet një furrë buke, e cila shkaktonte zhurma, aroma të shumta dhe nxehtësi, e cila në periudhën e verës e bënte pothuaj të pabanueshëm këtë apartament, si dhe pakënaqësi të vazhdueshme tek banorët e pallatit. Pas blerjes kam ardhur në dijeni se shitësi N.I kishte shumë ankesa kundrejt pronarit të furrës së bukës dhe madje konflikte të vazhdueshme me të. Në vitin 2008 njësia tregtare, për shkak edhe të ankesave të vazhdueshme të banorëve të pallatit edhe pranë Bashkisë Tiranë, ndryshoi destinacion duke mos qenë më furrë buke dhe vlera e shitjes në vitin 2008 u rrit, duke u shitur nga ana ime në datën 31.10.2008 në vlerën 4,318,000 lekë”.*

Komisioni, duke analizuar dokumentacionin si për blerjen/shitjen e kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pagesën e detyrimit tatimor nga kalimi i të drejtës së pronësisë për këtë pasuri të paluajtshme, vlerësoi se të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, e për këtë janë pasqyruar të plota në analizën financiare.

e. Të ardhurat nga shitja e një sipërfaqeje toke me kontratën nr. *, në shumën 227,000 lekë**

Për këtë pasuri, referuar të dhënave nga ASHK Drejtoria Rajonale Fier (shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 5.11.2021), në emër të shtetasve Aurel, F dhe M.Z , rezulton pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, e llojit arë me sipërfaqe totale 192 m², ndodhur në ***, Fier, regjistruar në datën 1.6.2011.

Në pasuritë e mëposhtme janë kryer transaksione dhe pasuritë kanë kaluar në emër të pronarëve të tjerë, si më poshtë vijon:

- Nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, e llojit arë me sipërfaqe totale 748 m², ndodhur në z. k. *** (***) , me kontratë shitjeje ka kaluar në pronarë të tjerë në datën 13.6.2011.
- Nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, e llojit arë me sipërfaqe totale 500 m², ndodhur në z. k. *** (***) , me kontratë shitjeje ka kaluar në pronarë të tjerë në datën 29.9.2010.
- Nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, e llojit arë me sipërfaqe totale 500 m², ndodhur në z. k. *** (***) , me kontratë shitjeje ka kaluar në pronarë të tjerë në datën 1.10.2010.
- Nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, e llojit arë me sipërfaqe totale 1000 m², ndodhur në z. k. *** (***) , me kontratë shitjeje ka kaluar në pronarë të tjerë në datën 12.9.2006.
- Nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, e llojit arë me sipërfaqe totale 1000 m², ndodhur në z. k. *** (***) , me kontratë shitjeje ka kaluar në pronarë të tjerë në datën 14.9.2004.

Këto pasuri janë përfituar nga nxjerrja e dëshmisë së trashëgimisë, ekzekutuar me vendimin nr. ***, datë 3.4.2003 (periudhë para fillimit të detyrës nga subjekti si magjistrat).

f. Të ardhurat nga shitja e një sipërfaqeje toke me kontratën nr. *, në shumën 227,000 lekë**

Për këtë pasuri rezultoi kontratë shitblerjeje nr. ***, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit, nëna dhe motra e tij shesin tokë arë me sipërfaqe 500 m², në z. k. ***, nr. pasurie ***, ***, Fier, kundrejt çmimit 454 lekë/m².

g. Të ardhurat nga shitja e një sipërfaqeje toke me kontratën nr. *, në shumën 340,000 lekë**

Për këtë pasuri, me kontratë shitjeje nr. ***, datë 3.6.2011, subjekti i rivlerësimit, së bashku me nënën, motrën dhe bashkëshorten kanë shitur një sipërfaqe toke prej 748 m², ***, Fier, kundrejt shumës 339,592 lekë.

8.14 Në lidhje me pjesën takuese të subjektit në këto pasuri, në përgjigje të pyetësorit nr. *** ka shpjeguar se nga trashëgimtarët e tjerë ligjorë të këtyre pasurive ka pasur shprehje vullneti lidhur me përfitim prej tij të të ardhurave nga shitja e tyre.

8.15 Gjithashtu u depozitua dhe u administrua nga Komisioni deklarata noteriale nr. ***, datë 21.8.2006, ku trashëgimtarët e të ndjerit T.Z , nëna e subjektit, znj. F.Z , dhe motra e tij kanë dhënë dakordësi që të ardhurat nga të gjitha këto pasuri të përfitohen nga subjekti, duke u disponuar lirisht prej tij.

8.16 Në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruara të përfituara nga kalimi i pronësisë për këto pasuri të paluajtshme, në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti ka deklaruar se: “...Për kontratën e shitblerjes së tokës arë nr. ***, datë 7.9.2004, për çmimin e shitjes së pasurisë në shumën 1,500,000 lekë tatimi është paguar sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 8.9.2004, në shumën 7,500 lekë.

*Në lidhje me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 18.9.2006, për shitjen e pasurisë tokë arë kundrejt çmimit prej 2,000,000 lekësh, është paguar tatimi sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 20.9.2006, në shumën 10,000 lekë.*

*Në lidhje me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 14.10.2006, për shitjen e pasurisë truall + ndërtesë në çmimin 1,900,000 lekë, tatimi është paguar sipas mandatarkëtimit nr. ***, datë 17.10.2006, në shumën 9,500 lekë.*

*Në lidhje me kontratën nr. ***, datë 3.9.2010, tatimi i paguar për shitjen e pasurisë nr. ***, z.k. ***, është paguar nga blerësi A.B sipas mandatit bankar datë 27.9.2010 të Tirana Bank, në shumën 10,972 lekë dhe përshkrimi “Paguar shitje 10% për ZVRPP A.B”.*

*Në lidhje me kontratën nr. ***, datë 3.9.2010, tatimi i paguar për shitjen e pasurisë nr. ***, z.k. ***, është paguar nga blerësi M.B sipas mandatit bankar datë 27.9.2010 të Tirana Bank, në shumën 10,972 lekë.*

*Në lidhje me kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 31.10.2008, për shitjen e pasurisë apartament kundrejt çmimit 4,138,000 lekë, është paguar tatimi në shumën 213,800 lekë (4,138,000 - 2,000,000) sipas mandatarkëtimit të Credins Bank datë 10.11.2008.*

*Në lidhje me kontratën e shitblerjes së tokës bujqësore nr. ***, datë 3.6.2011, sipas mandatit të Tirana Bank sh.a., datë 8.6.2011, është paguar tatimi në shumën 15,412 lekë...”.*

8.17 Gjithashtu, subjekti ka paraqitur si provë: (i) praktikën e akteve të marrë nga ASHK, Dega Vendore Fier, praktikë e cilat përmban edhe mandatpagesat e sipërcituara për pagimin e detyrimeve tatimore; (ii) praktikën e akteve të marrë nga ASHK, Dega Vendore Tiranë, praktikë e cila përmban edhe mandatpagesat e sipërcituara për pagimin e detyrimeve tatimore.

8.18 Komisioni ka administruar dokumentacionin përkatës¹³ lidhur me këto pasuri dhe kontratat e shitblerjes.

¹³ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 7.9.2004, ku shtetasit Aurel, F dhe M.Z shesin tokë me sip. 1.000 m² në z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, ***, Fier, kundrejt çmimit 1,500,000 lekë.

Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 18.9.2006, ku shtetasit Aurel, F dhe M.Z shesin tokë me sip. 1.000 m² në z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, ***, Fier, kundrejt çmimit 2,000,000 lekë + certifikatë për vërtetim pronësie datë 8.9.2006, për arë me sip. 1.000 m² në emër të z. Aurel Zarka + kartelë pasurie + hartë treguese e regjistrimit.

Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 14.10.2006, ku shtetasit Aurel, F dhe M.Z shesin truall me sip. 200 m², nga i cili ndërtesë me sip. 74 m², z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, ***, Fier, kundrejt çmimit 1,900,000 lekë.

Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 3.9.2010, ku shtetasit Aurel, F dhe M.Z shesin tokë arë me sip. 500 m² në z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, ***, Fier, kundrejt çmimit 454 lekë/m², + certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 23.7.2010, për arë me sip. 500 m², ***, Fier, në bashkëpronësi të shtetasve Aurel, F dhe M.Z + kartelë pasurie + hartë treguese e regjistrimit.

Vendim nr. ***, datë 4.8.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “Lëshim autorizimi për tjetërsim pasurie”.

certifikata të gjendjes familjare të shtetasve T.Z, F Z dhe Aurel Zarka.

Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 3.9.2010, ku shtetasit Aurel, F dhe M.Z shesin tokë arë me sip. 500 m² në z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, ***, Fier, kundrejt çmimit 454 lekë/m². Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 3.6.2011, ku shtetasit Aurel, F dhe M.Z shesin tokë arë me sip. 748 m² në z. k. ***, nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, ***, Fier, kundrejt çmimit 454 lekë/m² (me vendimin nr. ***, datë 4.8.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur dhënia e autorizimit për tjetërsimin e pjesës së fëmijës së mitur A.A.Z, në përputhje me nenin 234 të Kodit të Familjes, vendim i cili e konsideron bashkëpronar dhe në këtë cilësi merr pjesë në kontratë edhe për të nënshkruan me autorizimin e gjykatës babai i tij, z. Aurel Zarka) + certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 1.6.2011, për arë me sip. 748 m² në ***, Fier, në bashkëpronësi të shtetasve Aurel, F dhe M.Z + kartelë pasurie + hartë treguese e regjistrimit + certifikatë familjare + vendim nr. ***, datë 4.8.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vendim nr. ***, datë 18.3.2003, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin T.Z, duke njohur trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë shtetasit F, Aurel dhe M. Z.

Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 3.6.2011, ku shtetasit A, F, M dhe S. Z shesin tokë arë me sip. 748 m² në ***, Fier, nr. pasurie ***, me çmim 454 lekë/m² (citohet bashkëpronar në shitje me vendim gjykate edhe i mituri A.A.Z).

Kontratë shitblerjeje datë 3.9.2010, sipas së cilës shtetasit Aurel, F dhe M.Z shesin tokë arë me sip. 500 m² në ***, nr. pasurie ***, me çmim 454 lekë/m² (citohet bashkëpronar në shitje me vendim gjykate edhe i mituri A.A.Z).

Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 7.9.2004, sipas së cilës shtetasit Aurel, F dhe M.Z shesin tokë arë me sip. 1.000 m² në ***, nr. pasurie ***, me çmim 1,500,000 lekë.

Kontratë nr. ***, datë 13.1.2007, sipas së cilës z. Aurel Zarka blen nga shtetasi N. I apartament me sip. 59 m², në blv. “****”, Tiranë, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, kundrejt çmimit 2,000,000 lekë.

Kontratë shitjeje nr. ***, datë 31.10.2008, sipas së cilës z. Aurel Zarka u shet shtetasve P apartament me sip. 59 m², në blv. “****”, Tiranë, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, kundrejt çmimit 4,318,800 lekë, ose 73,200 lekë/m². Likuiduar para nënshkrimit të kontratës.

8.19 Në lidhje me mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për kursim/shtim të gjendjes së investimit në këtë shoqëri, këto likuiditete janë pasqyruar në vijim në analizën financiare.

Deklarimet e bashkëshortes së subjektit

9. Dyqan me sip. 63 m²

9.1 Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka deklaruar këtë pasuri, për të cilin si burim të ardhurash janë deklaruar të siguruara nga familja e saj. Shuma prej 6,200,000 lekësh është siguruar nga një depozitë në ProCredit Bank, ndërsa pjesën tjetër prej 5,000,000 lekësh i ka marrë hua në emër të nënës së saj, hua të cilën deklaroi se e ka shlyer në vitet e mëvonshme nga të ardhurat e saj dhe të familjes.

9.2 Në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës në vitin 2012, subjekti ka deklaruar ndër të tjera: “...dyqan 63 m² në rrugën “****”, Tiranë, në shumën 100,000 euro, blerë në vitin 2004 në emër të bashkëshortes (i papërfunduar), nga të ardhurat e prindërve të saj nga emigracioni (jo të martuar në kohën e blerjes)..”.

9.3 Në bazë të kontratës datë 30.9.2004, shoqëria ndërtimore “****” sh.p.k. po ndërton në rrugën “****”, Tiranë, një ndërtesë 8-katëshe, me destinacion banesë dhe ambiente tregtare. Znj. S.E ka porositur një dyqan me sipërfaqe ndërtimore 63 m² kundrejt çmimit 100,000 euro. Në kontratë është parashikuar që në momentin e lidhjes së kontratës datë 30.9.2004 u pagua nga porositësja shuma 16,500 euro; kësti i dytë në shumën 53,500 euro do të likuidohet në datën 7.10.2004; kësti i tretë në shumën 20,000 euro do të likuidohet në fund të muajit shkurt 2005 dhe kësti i fundit prej 10,000 euro do të dorëzohet në momentin e bërjes së kontratës së shitblerjes dhe regjistrimit të pallatit.

9.4 Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 28.6.2016¹⁴, shtetasi F.V ka deklaruar: “...në vitin 2004 i ka dhënë shtetases H.E shumën prej 5,000,000 lekësh, në formë huaje pa interes, me qëllim për blerjen nga vajza e saj të një dyqani që po ndërtohej në rr. “****”, Tiranë. Kjo shumë iu dha cash në dorë pa ndonjë akt noterial, duke u nisur nga marrëdhëniet miqësore që kishin në atë kohë. Shuma prej 5,000,000 lekësh më është kthyer në vitet në vazhdim me disa këste nga vajza e saj dhe më është likuiduar plotësisht në fund të vitit 2008”.

9.5 Referuar të dhënave nga ASHK Tirana Veri¹⁵ rezulton e regjistruar në llogari të shtetases S.H.Z pasuria me sip. 62.9 m² (për aktivitet) në rrugën “****”, Tiranë, përfituar nga leja e legalizimit datë 5.3.2018.

9.6 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ndër të tjera ka deklaruar se: “...Bashkëjetesa ligjore ka nisur në vitin 2009 dhe në datën 8.1.2010 ka ardhur në jetë djali ynë, A.Z. Në datën 4.5.2011 kemi lidhur martesë ligjore¹⁶”. Më tej, subjekti ka sqaruar: “...lidhur me këtë njësi shërbimi, vlera e rënë dakord nga palët në kontratën e sipërmarrjes së datës 30.9.2004 ka qenë 100,000 euro. Pagesat janë kryer cash në vlerën 90,000 euro, brenda muajit shkurt 2005 dhe

¹⁴ Faqja **** e dosjes *Vetting*.

¹⁵ Shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.11.2021.

¹⁶ Subjekti ka bashkëlidhur: (i) certifikatë martesë të shtetasve Aurel Zarka dhe S.Z, për martesën e lidhur në datën 4.5.2011, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative F, Bashkia Tiranë, datë 29.2.2024; (ii) certifikatë familjare për z. Aurel Zarka, për përbërjen familjare të datës 1.6.2011, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative F, Bashkia Tiranë, datë 29.2.2024.

vlera finale e çmimit të shitjes ka qenë 90,000 euro, për shkak të vonesës së sipërmarrësit në përfundimin dhe dorëzimin e objektit, dorëzim i cili është mundësuar shumë kohë më vonë, në vitin 2014. Pra, vlera e objektit ka qenë 100,000 euro, 10,000 prej te cilave nuk janë paguar në para, por janë kompensuar me detyrimet e sipërmarrësit ndaj bashkëshortes, veprim i cili nga ana financiare nuk e ul vlerën e objektit. Detyrimi i firmës së ndërtimit për t'i paguar porositësit 200 euro për çdo muaj vonesë përtej datës së përcaktuar për dorëzimin e objektit parashikohet në nenin 4, pika "b" e kontratës së porosisë.

Njëkohësisht nga sipërmarrësi nuk rezultojnë të jetë lidhur kontrata përfundimtare e shitblerjes dhe as regjistrimi i pallatit në ZVRPP-në Tiranë, i cili është regjistruar vetëm me anë të legalizimit në vitin 2018. Kjo është një tjetër arsye se pse nuk u pagua vlera prej 10,000 euro, si kësti i fundit sipas kontratës së datës 30.9.2004, në referim të pikës 4 të nenit 3 të saj.

9.7 Në lidhje me kohën e marrjes në dorëzim, subjekti ka shpjeguar se: "...Kjo pasuri është marrë në dorëzim në muajin qershor 2014. Pasuria ka filluar të përdoret në muajin tetor 2014, kur është dhënë në qiramarrje tek shtetasja E.S, kundrejt çmimit mujor prej 10,000 lekë/muaj. Nuk janë kryer investime shtesë nga ana ime".

Analizë e burimit të të ardhurave dhe mundësia financiare

9.8 Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit) ka deklaruar si burim të ardhura të siguruara nga familja e saj (shuma prej 6,200,000 lekësh është siguruar nga një depozitë në ProCredit Bank, ndërsa pjesën tjetër prej 5,000,000 lekësh i ka marrë hua në emër të nënës së saj, hua të cilën deklaroi se e ka shlyer në vitet e mëvonshme nga të ardhurat e saj dhe të familjes).

9.9 Në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës në vitin 2012, subjekti ka deklaruar si burim të ardhurat e prindërve të bashkëshortes nga emigracioni.

9.10 Sa më sipër, rezultoi se ka mospërputhje në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie nga bashkëshortja.

9.11 Në përgjigje të pyetësorit nr. *** lidhur me mospërputhjet në burimin e të ardhurave të deklaruara në deklarinimin para fillimit të detyrës në vitin 2012, me burimin e deklaruar në deklaratën *Vetting*, subjekti ka sqaruar se: "...deklarimi i bërë në deklaratën *Vetting* është ai i saktë dhe i detajuar. Deklarimi i bërë në deklaratën përpara fillimit të detyrës në vitin 2012 është plotësuar duke u deklaruar pjesa kryesore e burimit të të ardhurave, i cili vjen nga të ardhurat e prindërve të bashkëshortes nga puna në emigracion".

9.12 Gjithashtu, në këtë pyetësor, ka deklaruar ndër të tjera se: "...Burimi i të ardhurave, siç është deklaruar, janë: (i) depozita në ProCredit Bank në vlerën 6,200,000 lekë, e krijuar edhe nga fonde që vinin nga të ardhurat e prindërve të bashkëshortes nga emigracioni; (ii) huaja e marrë në muajin shtator 2004 nga nëna e bashkëshortes, shtetasja H.E, në masën 5,000,000 lekë, nga shtetasi F.V".

9.13 Subjekti ka depozituar edhe: (i) *statement*/lëvizje llogarie nga ProCredit Bank për llogarinë nr. *** në emër të shtetasës S.E, për periudhën 23.12.2003 – 31.1.2014; (ii) deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.6.2016, e shtetasit F.V, dhënë përpara noteres M.E.D, mbi huadhënien e shumës 5,000,000 lekë pa interes.

9.14 Referuar të dhënave nga ProCredit Bank rezulton se në datën 23.12.2003 shtetasja S.E ka depozituar në llogarinë në lek në emër të saj në këtë bankë shumën prej 6,000,000 lekësh dhe në datën 7.10.2004 është tërhequr *cash* shuma 6,234,841 lekë.

9.15 Në lidhje me burimin e të ardhurave të huadhënësit, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, ka përcjellë akte dhe dokumentacion justifikues mbi të ardhurat që ky shtetas realizonte në atë kohë, të cilat i kanë lejuar të jepte hua një vlerë të tillë. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se huaja është kthyer në *cash* me këste deri në fund të vitit 2008. Si burim të ardhurash kanë shërbyer të ardhurat e realizuara nga prindërit e bashkëshortes nga shitja e apartamentit me sip. 71.2 m², i ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, sipas kontratës së premtim shitjes datë 21.6.2004, me nr. *** regjistri.

9.16 Sa më sipër, Komisioni mban në konsideratë dhe vlerësim faktin se kjo pasuri është krijuar (përfshirë edhe likuidimin dhe shlyerjen e detyrimeve nga huaja) nga bashkëshortja e subjektit përpara kohës së deklaruar të lidhjes së tyre¹⁷, gjithashtu edhe përpara fillimit të detyrës si prokuror nga subjekti i rivlerësimit.

9.17 Në përfundim, për këtë pasuri dokumentohen burimet e deklaruara, shuma e tërhequr nga ProCredit Bank në datën 7.10.2004 dhe huaja e marrë nga shtetasi F. V në vitin 2004.

10. Llogari bankare

10.1 Llogari në emër të bashkëshortes së subjektit, hapur për llogari të djalit të xhaxhait L. E.

10.2 Në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës në vitin 2012, subjekti ka deklaruar në të dhënat konfidenciale: “...llogari bankare në emër të bashkëshortes, në shumën 35,000 euro. Kjo llogari është e djalit të xhaxhait, emigrant në Itali, i cili ka hapur llogari në emër të S.Z për lehtësi veprimesh në Shqipëri...”.

10.3 Subjekti nuk ka deklaruar institucionin bankar në të cilin është hapur kjo dhe/ose këto llogari.

10.4 Në DIPPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: “...Pakësim pasurie në shumën 3,000 euro, kthyer shtetasit L.E...”.

10.5 Në lidhje me kohën e hapjes së llogarive nga bashkëshortja e tij dhe depozitimit të shumës nga djali i xhaxhait të bashkëshortes, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. *** ka deklaruar se: “...Shumat nga djali i xhaxhait të bashkëshortes, shtetasi L.E , janë depozituar në dy banka: BKT dhe ProCredit Bank. Llogaria në BKT është hapur në emër të bashkëshortes, e cila ka depozituar në datën 10.2.2011 shumën prej 15,000 euro, të dhëna *cash* nga kushëriri i saj kohë më parë, të cilat ishin kursyer në llogarinë e bashkëshortes në ProCredit Bank dhe tërhequr prej saj në datën 4.2.2011, në vlerën 11,792 euro, ndërsa pjesa tjetër e dhënë *cash* nga shtetasi L.E . Llogaria në ProCredit Bank është hapur në emër të bashkëshortes dhe është kredituar në vlerën 15,000 euro nga transferta e bërë nga shtetasi L.E në datën 10.7.2012, me përshkrimin: “Italy – E.L, E B – S.H.E – 9.7.2012”. Pjesa tjetër prej 5,000 euro është dhënë *cash* prej tij. Në datën e dorëzimit të deklaratës përpara fillimit të detyrës (1.10.2012), bashkëshortja ime S.Z ka pasur gjendje në llogari të saj, për llogari të shtetasit L.E , vlerën prej 15,000 euro në BKT, 5,000 euro depozitë në ProCredit Bank dhe 14,429.59 euro gjendje në llogarinë rrjedhëse në ProCredit Bank, të cilat kanë formuar gjithsej vlerën prej 35,000

¹⁷ Bashkëjetesa ligjore ka nisur në vitin 2009... (përgjigje e pyetësorit nr. ***).

euro, të deklaruar prej meje në atë deklaratë. Gjatë vitit 2013, shtetasi L.E ka transferuar në llogarinë e bashkëshortes në ProCredit Bank shumën prej 15,000 euro, me përshkrimin "Germany – E.L, E.B – S. H. E – 7.8.2013". Kjo shumë është rikthyer në datën 2.5.2014, me tërheqjen e shumës prej 12,361 euro dhe pjesa tjetër plotësuar në cash".

10.6 Referuar të dhënave nga BKT-ja rezulton se në datën 10.2.2011 shtetasja S.Z ka depozituar *cash* në llogarinë në emër të saj shumën 15,000 euro. Kjo shumë ka kaluar periodikisht në depozitë me afat deri në datën 9.12.2016, datë në të cilën është tërhequr *cash* shuma prej 15,498.68 euro.

10.7 Referuar të dhënave nga ProCredit Bank rezulton se në datën 20.9.2011 futet në depozitë me afat shuma 5,000 euro deri në datën 20.9.2012. Në datën 10.7.2012 është kredituar kjo llogari (nr. ***) për shumën 14,975 euro nga shtetasit L.E e B.E. Gjendja e kësaj llogarie në datën 1.10.2012 është 14,430 euro.

10.8 Në datën 9.8.2013 është transferuar nga shtetasi L.E shuma 14,930 euro dhe në fund të vitit 2013, përveç depozitës në shumën 20,000 euro, në këtë llogari gjenden edhe 13,565 euro. Në datën 2.5.2014, znj. Z tërheq *cash* shumën 12,361 euro.

10.9 Në datën 11.5.2014 rikthehet depozita prej 20,000 euro dhe rivendoset deri në datën 11.5.2015 e, më pas, deri në vitin 2016. Në datën 19.12.2016 është tërhequr *cash* shuma 20,395 euro.

10.10 Sa më sipër, duket se ka mospërputhje të kohës së dhënies së shumës 35,000 euro, pasi në deklarinimin para fillimit të detyrës deklarohet se shuma është marrë, ndërsa në bazë të dokumentit nga ProCredit Bank rezultojnë dy transferta hyrëse: njëra në datën 10.7.2012 kur është kredituar kjo llogari (nr. ***) për shumën 14,975 euro nga shtetasit L.E e B.E dhe tjetra në datën 9.8.2013, ku është transferuar nga shtetasi L.E shuma 14,930 euro.

10.11 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka shpjeguar se: *"...vlera prej 15,000 euro është kthyer në datën 2.5.2014 nga bashkëshortja ime, duke iu dhënë cash z. L.E , i cili në atë kohë ka qëndruar për një periudhë të gjatë në Shqipëri dhe ishte angazhuar në ndërtimin e objektit shtëpi banimi në vendlindje... Në lidhje me kohën dhe mënyrën e kthimit të vlerës prej 35,000 euro, kjo shumë është kthyer në muajin dhjetor 2016 në dy këste prej 15,000 euro dhe 20,000 euro, të cilat i janë dorëzuar nga bashkëshortja ime shtetasit A.B në cash, sipas porosisë së dhënë nga z. L.E . Shtetasi A.B , teknik ndërtimi, ishte personi i cili ka ndjekur punimet për përfundimin e ndërtimit të shtëpisë së z. L.E në fshatin e tij të lindjes..."*

10.12 Ndërsa, në lidhje me përdorimin ose jo nga personi i lidhur dhe subjekti i këtyre vlerave monetare në pronësi të shtetasit L.E , subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. *** ka deklaruar se: *"...Interesat e maturuar nga dy depozitat në BKT dhe ProCredit Bank i janë dhënë shtetasit L.E , bashkë me principalin. Nga ana e bashkëshortes time nuk janë marrë përfitime nga këto vlera monetare..."*

Analiza e burimit të të ardhurave të shtetasit L.E për krijimin e këtyre depozitave të deklaruar nga subjekti

10.13 Në lidhje me burimin e të ardhurave të shtetasit L.E për krijimin e shumës 35,000 euro, subjekti me përgjigjen e pyetësorit nr. *** ka vënë në dispozicion aktet e sjella nga ky shtetas nga Republika e Italisë, “Estratto Conto Previdenziale” për të ardhurat e tij nga viti 1996 deri në vitin 2023¹⁸.

10.14 Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti, të ardhurat e dokumentuara të shtetasit L.E në shtetin italian për periudhën 2000 deri në datën 10.7.2012 (datë në të cilën është transferuar shuma 14,975 euro), rezultojnë në vlerën rreth 277,170 euro.

10.15 Në mungesë të të dhënave në lidhje me personat në ngarkim të shtetasit L.E (për efekt të llogaritjes së shpenzimeve jetike në shtetin italian¹⁹), të ardhura të tjera, pasurive të krijuara, si dhe shpenzime të kryera për këtë periudhë, duket se shtetasi L. E ka pasur mundësi për kreditimin e shumës 35,000 euro bashkëshortes së subjektit deri në datën 10.7.2012.

10.16 Mbështetur në deklaratimet e subjektit (deklarimin për herë të parë, deklaratën e interesave privatë për vitin 2016, ashtu edhe gjatë procesit), shoqëruar me dokumentacionin përkatës për marrëdhënien dhe burimin e të ardhurave të këtij shtetasi, Komisioni vlerësoi të pasqyrojë shumën 35,000 euro, në formë të një borxhi për bashkëshorten e subjektit, për periudhën përpara deklaratimit për herë të parë.

11. Tokë arë në * , Fier**

11.1 ZVRPP Fier²⁰ konfirmon në emër të z. Aurel Zarka pasuri aktive me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, arë me sip. 192 m², pajisur me certifikatë pronësie në bashkëpronësi me shtetasit F dhe M.Z . ZVRPP Fier ka theksuar se nuk disponon regjistrimet para vitit 1997, për shkak të djegieve të regjistrave të hipotekës gjatë marsit të vitit 1997.

11.2 Bashkëlidhur shkresave të ZVRPP-së Fier janë paraqitur kartela e pasurisë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, arë me sip. 192 m², në bashkëpronësi të shtetasve Aurel, F dhe M.Z (nëna dhe motra e subjektit). Data e lëshimit të certifikatës është 1.6.2011, së bashku me plan-rilevimin e pasurisë.

11.3 Fillimisht ka qenë e regjistruar pasuria me nr. ***, vol. ***, fq. ***, arë me sip. 1.940 m², e cila është mbyllur dhe ka vijuar me pasuritë:

- nr. ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 940 m²;
- nr. ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 500 m², shitur në datën 1.10.2010;
- nr. ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 500 m², shitur në datën 29.9.2010.

11.4 Pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, është mbyllur dhe ka vijuar me pasuritë:

- nr. ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 748 m², shitur në datën 13.6.2011;
- nr. ***, vol. ***, fq. ***, arë me sip. 192 m².

¹⁸ Dokumenti “Estratto Conto Previdenziale, regime generale”, lëshuar në datën 29.2.2024, me kod fiskal ***, lëshuar nga INPS (Instituti Kombëtar i Sigurime Shoqërore), Republika e Italisë, për të ardhurat e shtetasit L.E në periudhën 1996 – 31.12.2023; *email* dërguar nga shtetasi L.E nga adresa e tij ***@gmail.com në adresë të noterës publike S.K. B, në datën 4.3.2024, noterizuar nga noterja me vërtetim dhe verifikim të dokumentacionit nr. *** rep., datë 8.3.2024, bashkëlidhur praktika e dokumentit “Estratto Conto Previdenziale, regime generale”, lëshuar në datën 29.2.2024, me kod fiskal ***, lëshuar nga INPS (Instituti Kombëtar i Sigurime Shoqërore), Republika e Italisë, për të ardhurat e shtetasit L.E në periudhën 1996 – 31.12.2023.

¹⁹ Shpenzimet për jetesë llogariten në afro 102,000 euro për 1 person, për periudhën.

²⁰ Shihni shkresën e ardhur nga ZQRPP-ja, protokolluar në ILDKPKI me nr. ***, datë 9.8.2017 dhe shkresën nr. *** prot., datë 5.11.2021, në dosjen e Komisionit.

11.5 Pasuritë e mësipërme janë shitur dhe janë trajtuar në pikën 8 të këtij vendimi, kurse pasuria nr. *** figuron në pronësi të subjektit të rivlerësimit si bashkëpronar (pajisur me certifikatë pronësie në datën 1.6.2011, para fillimit të detyrës si magjistrat).

11.6 Rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratat e interesave privatë ndër vite dhe në deklaratën *Vetting*.

11.7 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

11.8 Në lidhje me këtë pasuri, në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka sqaruar se: *“Familja jonë ka pasur në pronësi tokën arë me sipërfaqe 1.940 m², e cila duke filluar nga viti 2010 është ndarë në 3 momente kohore, duke u shitur pjesë-pjesë tek persona të tretë, të cilët i kanë përdorur më pas sipërfaqet e blera për të ushtruar veprimtari industriale.*

Konkretisht, janë realizuar 3 (tri) shitje:

- 500 m² në datën 29.9.2010

- 500 m² në datën 1.10.2010

- 748 m² në datën 13.6.2011

*Sqaroj se këto 3 sipërfaqe toke u janë shitur personave të ndryshëm, pra jo të njëjtit person, dhe rrjedhimisht ishte e nevojshme që të kishin dhe rrugë kalimi/servitut kalimi për secilën pronë. Dhe kjo rrugë kalimi, nga interesimi i sotshëm, pasi jam njohur me raportin e Komisionit, është pasuria me nr. *** vol. ***, fq. ***, arë me sip. 192 m², e cila ende figuron në pronësinë time dhe të 2 bashkëpronarëve të tjerë (nëna ime F.Z dhe motra M.Z).*

*Theksoj se me shitjen e 3 (tri) pasurive më lart, në vitet 2010 – 2011, ne kemi konceptuar se është shitur në tërësi prona e llojit arë dhe nuk kishim më të drejta mbi të. Nga aktet e tanishme dhe provat që kërkuj t’ju paraqes rezulton e qartë se pasuria nr. ***, vol. ***, fq. ***, arë me sip. 192 m², përfaqëson rrugën e cila shërben për të aksesuar secilën nga pronat”.*

11.9 Në mbështetje të qëndrimit dhe shpjegimeve, subjekti ka paraqitur edhe provat shkresore²¹.

Vlerësimi i Komisionit

11.10 Në përfundim, Komisioni vlerësoi se kjo pasuri nuk mund të konsiderohet si pasuri e fshehur edhe për faktin se pasuria me sipërfaqe 1.940 m² është deklaruar nga subjekti si pasuri nga e cila ka krijuar të ardhura financiare. Rezultoi se kjo pasuri tokë arë është përfituar me anë të trashëgimisë ligjore para fillimit të detyrës nga ana e subjektit të rivlerësimit.

²¹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.6.2024, hartuar përpara noteres S. K. B, nga deklaruesit Aurel Zarka, F.Z dhe M.Z, për kalimin në favor të shtetit të pasurisë së paluajtshme nr. ***, vol. ***, fq. ***, arë me sip. 192 m²; plan-rilevimi për punime kadastrale për pasurinë nr. ***, vol. ***, fq. ***, arë me sip. 192 m², zona kadastrale ***, përgatitur nga eksperti topograf ing. E. Gj, datë 10.6.2024 (2 fletë); aplikim në sistemin e ASHK-së për heqje dorë nga pronësia mbi këtë pasuri.

12. Analiza financiare

12.1 Analiza e treguesve financiarë është kryer nga Komisioni për periudhën nga fillimi i detyrës së subjektit deri në datën 31.12.2016 (dhe jo vetëm), mbështetur në dokumentacionin e disponuar, si dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

12.2 Në analizë të burimit të të ardhurave për krijimin e pasurive të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe mundësisë financiare për këto burime, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të deklaruara/dokumentuara për blerje/krijim të pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe evidentuara për këto vite.

12.3 Në lidhje me pamundësinë financiare prej -158,167 lekësh për vitet 2012 – 2016, të pasqyruar në analizën financiare, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime, çështje e cila është trajtuar në pikën 1 të këtij vendimi.

12.4 Referuar parimit të proporcionalitetit, për Komisionin kjo pamundësi financiare në këtë vlerë, nuk mund të ndikonte në vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit në lidhje me kriterin e pasurisë.

12.5 Si përfundim, në rastin e subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta dhe ligji ka parashikuar për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

12.6 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

Periudha		dt. 06.06.2012	7/06/2012-31/12/2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
Perberja familjare (certifikate); deklarim/nr. persona		3; 4 dhe 5	5 dhe 3	3 dhe 4	4	4	4
KATEGORI	NËKATEGORI						
ASETE							
*	Apartament me sip.1104 m2 dhe 2 garazhe me sip.20 m2 secili, Selite, Tiranë - 84.000 Euro;		1172560				
*	Ap.me sip.84 m2, Vlorë, 27.000 Euro;	335660					
*	Njësi me sip.63 m2, në rr.*** Tiranë (kon. sipërmarrje dt. 30.09.2004, 100.000 Euro (bshkëshorte para bashkëjetese, martesë);						
*	Autoveturë Ford Fiesta, blerë në 30.07.2012 - 3.500 Euro, në emër të bashkëshortes , shitur ne date 2.10.2014 në shumën 4.000 Euro;		488565		-500560		
*	Autoveturë BMW 320D (targë***) ,blerë me kontratë datë 24.10.2013 - 100.000 lek;			100000			
	Likuiditete (ndryshim gjendje, shtesa/pakësime)	9742891	-4401850	1973862	-1142015	-479468	-5277815
	TOTALI	13099551	7812275	2073862	-1702575	-479468	-5277815
DETYRIME							
	Huadhënie nga L. E. në llogari të përsosur të lidhur bashkëshorte;		4885650	2103000	-2103000		-4885650
	Detyrime shoqërisë ndërtuese **** shpk, (k.sipërmarrje date 01.10.2012 për apartamentin në Selite);		697950			-697950	
	TOTALI	0	5583600	2103000	-2103000	-697950	-4885650
TE ARDHURA							
	Te ardhura neto nga paga e subjektit të rivlerësimit si prokuror, për periudhën 07.06.2012-31.12.2016;		421599	841446	1043568	1073870	1148332
	Te ardhura neto nga paga e personit të lidhur (bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit) për periudhën 07.06.2012-31.12.2016;		491295	646753	74906		97024
	Te ardhura përfitime nga leje lindja bashkëshortja sipas ProCredit dhe Union Bank;			81480	556106		
*	Te ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit subjekti dokumentuar për periudhën 04/2001-6/06/2012;	7658533					
*	Te ardhurat nga marrëdhëniet e punësimit bashkëshortes për periudhën 01.01.2009-06.06.2012;	3376307					
*	Te ardhura nga përfitime sig. shoqërore viti 2010, bashkëshorte;	356815					
*	Te ardhura të nënës (pension familjar) deri në datë 01.09.2012;	46762	20563				
*	Te ardhura të motrës (pension familjar) për periudhën 05.03.2002-31.08.2006;	233138					
*	Te ardhura të motrës nga paga për periudhën deri 05/2012;	3930237					
*	Te ardhura të motrës nga paga për periudhën 06/2012-08/2012;		169026				
*	Te ardhura përfituar nga K.shitjes e dates 7.09.2004, shuma 1.500.000 lek;	1500000					
*	Te ardhura përfituar nga K.shitjes e dates 18.09.2006, shuma 2.000.000 lek;	2000000					
*	Te ardhura përfituar nga K.shitjes e dates 14.10.2006, shuma 1.900.000 lek;	1900000					
*	Te ardhura neto të përfituar shija e ap. ne Tirane k.shitje dt.31.10.2008, në shumën 4.318.800 lek;	2318800					
*	Te ardhura përfituar nga K.shitjes e dates 3.09.2010, shuma 227.000 lek;	227000					
*	Te ardhura përfituar nga K.shitjes e dates 3.09.2010, shuma 227.000 lek;	227000					
*	Te ardhura përfituar nga K.shitjes e dates 3.06.2011, shuma 339.592 lek;	339592					
*	Te ardhura nga huadhënia e babait nga kurseme deri 2001 (kthyer ne vitin 2007 deklaruar);	4871200					
*	Te ardhura nga kontrata e huasë së babait në vitin 2001 (sistemim cmm ap. Vlore);	3356660					
*	Te ardhura nga interesa bshkeshorte 01.01.2009-06.06.2012;	92423					
*	Te ardhura interesa bankare subjektit per periudhen deri 06/06/2012;	1209775					
*	Te ardhur /bonus femije 2010;	5000					
*	Te ardhura /kompensim per shpenzime semnar Kivaci viti 2009, transferuar ne bankë;	22625					
*	Te ardhura nga interes depozite ne Lek, në emër të subjektit në Raiffeisen Bank;		341132	101624	6328	2784	
*	Te ardhura nga interes depozite ne emër të bashkëshortes së subjektit në Procredit Bank llog. Euro;			1451	499		
*	Te ardhura nga interes depozite ne emër të bashkëshortes së subjektit në Procredit Bank llog. Euro;			5622	50450	2376	2346
*	Te ardhura nga interes depozite ne emër të bashkëshortes së subjektit në Procredit Bank llog. Lek;						
*	Te ardhura nga interes depozite ne emër të bashkëshortes së subjektit në BKT llog. Euro hapur ne vitin 2011, mbyllur date 9.12.2016;		34060				67346
*	Shumë e kthyer nga motra në datë 27/09/2012 në Raiffeisen bank (shlyerje e kështj të shtëpisë);	1500000					
*	Te ardhura nga kembimi, shlyerja e kështj të fundit apartamenti dhe garazhet ne Selite;					11550	
	TOTALI	33671867	2977675	1678376	1731857	1090580	1315048
SHPENZIME							
	Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit për periudhën 7/06/2012-31/12/2016;		123956	150715	14014	133162	411099
	Shpenzime për automjetin "Ford" deklaruar ne pyetesor 2;		100000				
	Shpenzim shëndetësi në vitin 2013, deklaruar në përgjigje të pyetësorit standart (P.18);			322460			
*	Shpenzim interesa bankare te paguara (sistemim interesave kreditore nga likuiditetet e shtetasit L.E.);	56826		34060			122519
*	Shpenzime udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit për periudhën deri në datë 06/06/2012;	471793					
*	Tatim mbi interes Bono Theban 2009-2010;	37877					
*	Tatim per transferimin e pronesisë te pasurisë se palajshme apartament ne rr.*** Tiranë, date 10.11.2008;	214100					
*	Tatim per transferimin e pronesisë te pasurisë se palajshme deklaruar pyet 2;	64356					
*	Shpenzim mobilimi ap. në Vlorë deklaruar pyetësor 2; (2011- fillim 2012);	30000					
*	Blerje ap.me sip.49 m2, tek **** shpk në kormk 2012 nga motra dhe shtetas F.N në shumën 2.107.000 lekë (vendosur pjesa 1.500.000 leke e motres shlyer viti 2008);	1500000					
*	Blerje ap. banimi me sip.99 m2, ne ***** shpk porositur në vitin 2006 dhe transferuar pa shpërbim tek motra në vitin 2012;	5301900					
*	Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën 04/2001-06/06/2012 (3, 4 dhe 5 persona);	4186394					
*	Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën 07/06/2012-31/12/2012 (5 dhe 3, dhe 4 persona);		304329	453209	879992	897104	940368
	TOTALI	12133246	528285	960444	894006	1030266	1473986
	ANALIZA FINANCIARE	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016
1	Te ardhura	33671867	2977675	1678376	1731857	1090580	1315048
2	Asete	13099551	7812275	2073862	-1702575	-479468	-5277815
3	Detyrime	0	5583600	2103000	-2103000	-697950	-4885650
4	Shpenzime	12133246	528285	960444	894006	1030266	1473986
	Balanca e fondeve (1-2+3-4)	8439070	220715	747070	437426	-158167	233228

12.7 Shpjegime të analizës së treguesve financiarë

Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë për kategoritë pasuri, detyrime, të ardhura dhe shpenzime për periudhën që nga fillimi i detyrës, në datën 6.6.2012, deri më 31.12.2016 (dhe jo vetëm), mbështetur në dokumentacionin justifikues ligjor të administruar, deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, duke analizuar burimin e deklaruar të të ardhurave për krijimin e pasurive (të paluajtshme, të luajtshme dhe likuiditete), si dhe mbulimin e shpenzimeve të ndryshme. Të dhënat e paraqitura janë në lek.

Të ardhurat

- i. të ardhurat²² nga marrëdhëniet e punësimit të subjektit të rivlerësimit janë pasqyruar në vlerën neto, referuar dokumentacionit përkatës ligjor dhe financiar/bankar;
- ii. të ardhurat e përfituara nga shitja e tokës dhe shtëpisë në Fier, në vitet 2004 – 2011;
- iii. të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Tiranë, në vitin 2008;
- iv. të ardhurat nga kthimi i shumës 40,000 euro në vitin 2007 nga huadhënia e babait (të ndjerë) të subjektit, dhënë në vitin 2001 shtetasit H. Sh.;
- v. të ardhurat nga interesat bankarë të subjektit dhe personit të lidhur (bashkëshortes)²³;
- vi. të ardhurat e dokumentuara për nënën²⁴ dhe motrën e subjektit²⁵ për periudhën deri në datën 1.9.2012;
- vii. të ardhurat nga shuma e kthyer nga motra në datën 27.9.2012 nëpërmjet Raiffeisen Bank (shlyerje e këstit të shtëpisë), si sistemim i veprimit, ku nga subjekti është dhënë e njëjta shumë në vitin 2008 (deklaruar kthim kontributi)²⁶.

Shpenzimet janë pasqyruar referuar dokumentacionit përkatës ligjor, financiar dhe bankar, si dhe deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit:

- i. shpenzime për interesa dhe komisione bankare janë pasqyruar referuar dokumentacionit përkatës bankar;
- ii. shpenzime të tjera, sigurime, regjistrime, taksa automjeti etj. janë pasqyruar referuar dokumentacionit përkatës ligjor/financiar;
- iii. shpenzime për udhëtimet jashtë vendit (shpenzime transporti dhe qëndrimi) janë pasqyruar/llogaritur mbi bazë të dokumentacionit ligjor të disponuar, deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe referuar metodologjisë së aplikuar nga Kolegji²⁷. Në rastet kur shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit janë mbuluar nga të tretë, deklaruar nga subjekti

²² *Për subjektin*: vërtetim nr. ***, datë 19.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; vërtetim nr. ***, datë 2.11.2016, nga Prokuroria për Krime të Rënda; vërtetim nr. ***, datë 24.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; vërtetim nr. ***, datë 24.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Të dhëna nga Credins Bank me shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2021; dokumentacion nga të dhëna të bankave të nivelit dytë.

Për personin e lidhur: vërtetim datë 18.1.2017 nga ***, vërtetim nr. ***, datë 7.6.2016, nga *** sh.a.; vërtetim nr. *** prot., datë 26.1.2017, nga Bashkia Tiranë; të dhëna nga ProCredit Bank, Union Bank dhe Credins Bank në vitin 2016.

²³ Të dhënat për bashkëshorten fillojnë nga data 1.1.2009, kohë në të cilën subjekti ka deklaruar fillimin e bashkëjetesës.

²⁴ Referuar shkresës nr. *** prot., datë 13.5.2024, të ISSH-së.

²⁵ Vërtetim nga Union Bank dhe ABI Bank për të ardhura nga paga për periudhën 2006 – 2012 dhe nga ISSH-ja, dokumentacion i depozituar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. ***.

²⁶ Përgjigje e pyetësorit nr. ***.

²⁷ Vendim nr. 11, datë 22.5.2019, i Kolegjit.

- në përgjigje të pyetësorit standard dhe nr. ***, si financime/dhurime (mbi shumën 500 euro), Komisioni ka vlerësuar që shpenzimet e udhëtimit të mbeten në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, mbështetur në faktin se nuk janë deklaruar si dhurim në DIPPV-të përkatëse dhe në deklaratën *Vetting*, ndërsa shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur sipas jurisprudencës së Kolegjit;
- iv. shpenzime për pagesat e tatimit mbi interesa për bonot e thesarit, si dhe për tatimin nga kalimi i të drejtës së pronësisë të pasurive të paluajtshme;
 - v. shpenzime shëndeti në vitin 2013, deklaruar në përgjigje të pyetësorit standard (p.18);
 - vi. shpenzime për blerje mobilieje për apartamentin në Vlorë, shuma 300,000 lekë, për periudhën 2011 – fillim 2012, deklaruar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. ***;
 - vii. shpenzim/dalje likuiditetesh, shuma 5,301,900 lekë, për blerje të apartamentit të banimit me sip. 99 m² tek shoqëria “****” sh.p.k., porositur në vitin 2006 dhe transferuar pa shpërblim tek motra në vitin 2012;
 - viii. shpenzime për interesat kreditore, të përfituara nga likuiditetet e shtetasit L. E. në llogari të personit të lidhur (bashkëshortes së subjektit);
 - ix. shpenzime jetese, bazuar në të dhënat nga INSTAT dhe ILDKPKI, në raport me numrin e personave në bashkëjetesë, referuar edhe deklarimeve të subjektit.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim AKSIK-ja ka dërguar raportin e deklasifikuar plotësisht për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

3. Si konkluzion, Grupi i Punës konstatoi përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit.

4. Me shkresën nr. *** prot., datë 22.2.2024, AKSIK-së i është kërkuar përditësimi dhe deklasifikimi i raportit të figurës së subjektit.

5. AKSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 27.5.2024, ka dërguar²⁸ raportin e Grupit të Punës nr. ***, datë 30.10.2017. Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 23.5.2024, të KDZH-së.

²⁸ Protokolluar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 29.5.2024.

6. Pavarësisht nga raporti i dërguar nga AKSIK-ja, ku konstatohet përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës së subjektit, Komisioni ka kryer hetim administrativ, nga ku rezultoi se:

- nuk ka asnjë informacion apo *indicie* që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës sipas dokumentacionit të administruar;
- nuk ka çështje penale apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit;
- nuk ka të dhëna implikuese me persona të përfshirë në veprimtari kriminale në lidhje me subjektin e rivlerësimit, referuar të dhënave të administruara;
- nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

Në përfundim të hetimit, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin Aurel Zarka është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

2. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

3. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- i) formularit të vetëdeklarimit, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- ii) 5 dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- iii) të dhënave nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

Formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit

4. Formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti në formularin e vetëdeklarimit ka deklaruar një shifër të përgjithshme për tri vitet e fundit të çështjeve të caktuara, të përfunduara dhe të mbartura, pa iu referuar viteve, muajve e datave konkretisht.

5. Me Dekret të Presidentit të Republikës nr. ***, datë 4.6.2012, z. Aurel Zarka është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

6. Me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. ***, datë 9.5.2022, z. Aurel Zarka është caktuar në detyrën e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

7. Prokuror Aurel Zarka prej vitit 2012 deri në tetor 2016 ka qenë me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

8. Detyrat e subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka, si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kanë konsistuar në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin dhe kontrollin e hetimeve të kryera nga policia gjyqësore, si dhe përfaqësimin e çështjeve penale në gjykatë.

9. Prokurori Aurel Zarka ka deklaruar se ka trajtuar:

- Në vitin 2014 i janë caktuar për hetim 307 çështje, ka përfunduar 229 prej tyre.
- Në vitin 2015 i janë caktuar për hetim 325 çështje, ka përfunduar 301 prej tyre.
- Në vitin 2016 i janë caktuar për hetim 296 çështje, ka përfunduar 248 prej tyre.
- Numri i çështjeve të mbartura: për vitin 2015, 78 çështje; për vitin 2016, 24 çështje; për vitin 2017, 48 çështje.

10. Sipas të dhënave të marra zyrtarisht në momentin e hedhjes së shortit mbi çështjet objekt rivlerësimi, referuar procesverbalit për pasqyrimin e veprimeve të përzgjedhjes së 5 dosjeve për subjektin e rivlerësimit Aurel Zarka, rezulton se subjekti për periudhën 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016 ka trajtuar gjithsej 419 çështje, pa përfshirë edhe çështjet e pezulluara.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

1. Kërkesë për gjykimin e drejtpërdrejtë, vleftësimin e arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal

Akti është përpiluar dhe nënshkruar nga Aurel Zarka në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me anë të këtij akti prokurori pasi ka përfunduar hetimet i ka konsideruar provat të plota dhe i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë gjykimin e drejtpërdrejtë të të pandehurit E. B., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, parashikuar nga neni 279/1 i Kodit Penal.

Rrethanat e faktit: Në datën 29.9.2016 është ushtruar kontroll në banesën e shtetasit E.B , ku është gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale një përforcues grushti (dorezë metalike) me ngjyrë të kuqe.

Shtetasi E. B., i pyetur në cilësinë e personit nën hetim, deklaroi se ka 3 muaj që ka dalë nga burgu dhe doreza metalike është e tij dhe e ka pasur që para shumë kohësh, para se të futej në burg. Nga akti i ekspertimit teknik nr. ***, datë 30.9.2016, rezulton se përforcuesi i grushtit, objekt ekspertimit, plotëson kushtet teknike për t’u quajtur armë e ftohtë. Nga sa më sipër, rezulton e provuar se i pandehuri E.B ka konsumuar plotësisht elementet e veprës penale “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, vepër e parashikuar nga neni 279/1 i Kodit Penal.

Në lidhje me këtë ngjarje është kryer arrestimi në flagrancë i shtetasit E. B., me iniciativë nga policia gjyqësore, në orën 03:00 të datës 29.9.2016, si i dyshuar për veprën penale “Prodhimi,

mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, vepër e parashikuar nga neni 279/1 i Kodit Penal.

Mbështetur në sa më sipër, në bazë të neneve 228, 229, 244, 251, 258, 259, 331 dhe 400 të Kodit Penal, prokurori ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale etj. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 1.12.2016, ka vendosur mospranimin e ankimit.

Subjekti ka bërë një analizë të fakteve që kanë rezultuar nga hetimi, duke analizuar në mënyrë të posaçme kushtet dhe kriteret e masave të sigurimit, si dhe të paraqitjes së kërkesës për gjykim të drejtpërdrejtë në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

2. Ankim kundër vendimit nr. *, datë 25.4.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë**

Akti është përpiluar dhe nënshkruar nga Aurel Zarka në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Me anë të këtij akti, prokurori pasi ka analizuar vendimin nr. ***, datë 25.4.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, paraqet arsyet pse ky vendim duhet të ndryshohet nga Gjykata e Apelit Vlorë.

Me anë të vendimit nr. ***, datë 25.4.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndër të tjera është vendosur: *Deklarimi fajtor të të pandehurit L. F. për kryerjen e veprës penale “Kultivimi të bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim; Deklarimin fajtor të të pandehurit H. Gj. për kryerjen e veprës penale “Moskallëzim i krimi”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 10 muaj burgim.*

Prokurori në këtë vendim të gjykatës e çmon pjesërisht si të pabazuar në ligj dhe paraqet apel për sa i përket kualifikimit të veprës penale për të pandehurin H. Gj. Bazuar në nenet 407, 408, 412, 413, 415, 422 dhe 428/1/b të Kodit të Procedurës Penale, i kërkon Gjykatës së Apelit:

- Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 25.4.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke vendosur sipas kërkesës së prokurorit të seancës, konkretisht:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit L. F. për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, duke e dënuar me 5 vjet burg.

- Deklarimin fajtor të të pandehurit H. Gj. për kryerjen e veprës penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, duke e dënuar me 7 vjet burg etj.

Gjykata e Apelit Vlorë, me anë të vendimit nr. ***, datë 29.9.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit gjyqësor penal nr. ***, datë 25.4.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Nga përmbajtja konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta dhe përmbajnë referenca ligjore. Teksti paraqitet i kuptueshëm dhe i ndarë në paragrafë, duke përmendur dhe analizuar drejt elementet e veprës penale dhe provat, duke u bazuar në normat e Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, si dhe në praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë.

3. Konkluzione përfundimtare në shqyrtimin gjyqësor të procedimit penal nr. * të vitit 2014**

Akti është përpiluar dhe nënshkruar nga prokurori Aurel Zarka. Me anë të këtij akti, prokurori pasi ka analizuar rrethanat e faktit, provat në ngarkim të të pandehurve, rrethanat rënduese dhe

lehtësuese, i ka kërkuar gjykatës deklarinim fajtor të të pandehurve për akuzat në ngarkim të tyre.

Në fillim të aktit prokurori paraqet të pandehurit dhe akuzat në ngarkim të tyre:

- A. Y., akuzuar se ka kryer veprat penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” e kryer në bashkëpunim dhe “Plagosja e lehtë me dashje”, parashikuar nga nenet 79/e e 25 dhe 89 të Kodit Penal.

- E. Z., akuzuar se ka kryer veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 79/e dhe 25 të Kodit Penal.

- M. Z., akuzuar se ka kryer veprën penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” e kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 79/e dhe 25 të Kodit Penal.

Bazuar në nenin 378 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i kërkoi gjykatës dënimin e tyre, përkatësisht me burgim të përjetshëm dhe me 35 vjet burgim etj. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 20.10.2016, ka disponuar sipas kërkesave të prokurorit.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 6.4.2017, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 20.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në lidhje me cilësimin juridik, masën e dënimit, mënyrën e vuajtjes së tij për akuzën e veprës penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese”, në mënyrë të tillë që i shkakton mundime të veçanta viktimës, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 79/e dhe 25 të Kodit Penal për secilin nga të pandehurit A. Y. dhe E. Z. dhe Ndryshimin e vendimit për të pandehurin M. Z për kryerjen e veprës penale “Përkrahja e autorit të krimit”, parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim etj.”.

Nuk janë konstatuar problematika lidhur me këto 3 çështje.

Përshkrimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short

Dosja nr. 1. Gjetjet në dokumentin ligjor “Vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015”. Akti është i datës 23.2.2015, përpiluar dhe nënshkruar nga Aurel Zarka në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me anë të këtij akti, prokurori pasi ka paraqitur rrethanat e faktit, pas analizës së provave dhe veprës penale përkatëse, ka arritur në përfundimin se procedimi penal nuk duhet të fillohet.

Rrethanat e faktit: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, mbi bazën e akteve të referuara nga policia gjyqësore e Komisarariatit të Policisë Vlorë. Nga hetimet dhe veprimet verifikuese të kryera për këtë kallëzim penal ka rezultuar se shtetasi Sh. Xh. ka një shtëpi banimi në lagjen “***”, Vlorë, e cila është dykatëshe. Në datën 25.1.2015 është konstatuar se në këtë objekt po kryheshin punime pa leje (ndërtim i mureve të brendshme). Nga deklarimi i shtetasit Th. B. rezulton se ai është kontraktuar nga pronari i banesës Sh. Xh., i cili jeton me familjen në Greqi dhe i ka thënë në telefon që të bëjë ndërtimin e mureve të katit të parë të banesës, pasi kati i dytë ka qenë i përfunduar.

Nga deklarimi i shtetasit Sh. Xh. rezulton se ai ka ndërtuar një shtëpi banimi në një sipërfaqe toke të cilën ia ka blerë shtetasit F.A. Në fillim ka ndërtuar vetëm katin e dytë të shtëpisë, për shkak të mundësive financiare dhe në vitin 2013 ka paraqitur kërkesën për legalizim në bazë të ligjit. Para rreth një muaji ka vendosur të vazhdojë punimet në banesën e tij, konkretisht në katin e parë, duke bërë rrethimin me mure të këtij kati.

Është administruar kërkesa për legalizim në emër të shtetasit Sh. Xh., e cila mban datën 12.6.2013, ku është specifikuar numri i kateve, dy, dhe sipërfaqja e bazës së ndërtimit 105 m². Nga analiza e fakteve të mësipërme rezulton se ndërtimi pa leje i kryer nga shtetasi Sh. Xh. është kryer para datës 12.6.2013.

Në nenin 199/a të Kodit Penal është sanksionuar se: *“Ndërtimi i paligjshëm i një objekti në tokën e vet dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Po kjo veprë, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”*.

Lidhur me pronësinë e sipërfaqes së tokës, ky ndërtim konsiderohet në tokën e tij, megjithëse shtetasi Sh. Xh. nuk e ka blerë tokën në formën e kërkuar nga ligji.

Në bazë të ligjit “Për dhënie amnistie”, hyrë në fuqi në datën 10.4.2014, neni 5 i këtij ligji parashikon se: *“Amnistohen nga ndjekja penale të gjithë personat të cilët deri në datën 31 dhjetor 2013 kanë kryer vepra penale të cilat parashikojnë një dënim në maksimum deri në dy vjet burgim ose çdo lloj dënimi tjetër më të lehtë, me përjashtim të veprave të parashikuara në pikën 2 të nenit 6 të këtij ligji”*. Neni 6, pika 2 e ligjit “Për dhënie amnistie”, “Kriteret ndaluese për përfitimin e amnistisë”, përcakton se: *“Nuk përfitojnë nga parashikimet e nenit 5 të këtij ligji personat që kanë kryer vepra penale të parashikuara nga paragrafi i parë i nenit 137, neni 182, neni 197, paragrafi i parë i nenit 197/a, paragrafi i parë i nenit 235, paragrafi i parë i nenit 236 dhe neni 291 të Kodit Penal”*.

Ndodhur në këto kushte, duke analizuar gjithë provat dhe faktet e këtij kallëzimi penal, arrihet në përfundimin se nuk ndodhemi para veprës penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, prandaj nuk mund të fillojë ndjekja penale në lidhje me këtë veprë.

Bazuar në nenin 290/1, shkronjat “ç” dhe “dh” të Kodit të Procedurës Penale, prokurori ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për referimin penal nr. *** etj.

Nga përgjigjja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 14.11.2019, rezulton se ndaj vendimit të mosfillimit të prokurorit nuk është bërë ankim në Gjykatë.

Dosja nr. 2. Gjetjet në dokumentin ligjor “Vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. ****”. Akti është i datës 2.12.2013, përpiluar dhe nënshkruar nga Aurel Zarka, në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me anë të këtij akti, prokurori pasi ka shqyrtuar aktet e kallëzimit ka konkluduar se fakti nuk ekziston dhe, për këtë arsye, procedimi duhet të pushohet.

Me anën e materialit të referuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Vlorë është kërkuar fillimi i ndjekjes penale në ngarkim të shtetasit E. Sh., i cili dyshohet se ka bërë ndërtim pa leje në lagjen “****”, pallati ***, Vlorë. Është kryer këqyrja e vendit të ngjarjes, ku rezultoi se shtetasi E. Sh. ka ndërtuar një mur të lartë 2,4 m në tarracën e pallatit. U shoqëruan punëtorët K. L. dhe A. M., të cilët në deklarimin e tyre shpjeguan se ishin pajtuar nga ana shtetasit E. Sh. për këtë ndërtim. U pyet shtetasi E. Sh., i cili pranon autorësinë e ndërtimit të këtij muri, i cili kishte problem me arkitrarin e tarracës për shkak të bolierëve të ujit që ishin vendosur aty nga fqinjët.

Në analizë të fakteve të mësipërme rezulton se objekti i kësaj vepre janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të mbrojtur regjimin juridik të tokës, paprekshmërinë e saj, si dhe destinacionin e përcaktuar dhe mënyrën e shfrytëzimit të tokës. Në mënyrë të posaçme, neni 199/a i Kodit Penal synon të mbrojë paprekshmërinë e tokës nga ndërtimet e paligjshme të kryera nga të pandehurit apo personat e tjerë. Pra, objekti i kësaj vepre është një send i veçantë në qarkullimin civil. Në këtë rast ndërtimi i murit është bërë në tarracën e pallatit.

Bazuar në nenin 290, shkronja “ç” dhe nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, nga ana e prokurorit është vendosur: *Mosfillimi i procedimit penal lidhur me materialin kallëzues nr. ***, për veprën penale “Ndërtimi pa leje”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal etj.*

Nga shkresa nr. *** prot., datë 14.11.2019, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezultoi se ndaj vendimit të mosfillimit të prokurorit nuk është bërë ankim në Gjykatë.

Dosja nr. 3. Gjetjet në dokumentin ligjor “Vendim për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2013”. Akti është i datës 1.11.2013, përpiluar dhe nënshkruar nga Aurel Zarka, në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Me anë të këtij akti prokurori, pasi ka kryer hetimet, ka analizuar faktin dhe provat, ka konkluduar se fakti kriminal ekziston, por ndjekja penale nuk mund të fillojë për shkak të parashkrimit të veprës penale.

Rrethanat e faktit: Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është bërë protokollimi hyrës me nr. *** i materialit hetimor të kallëzuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Vlorë, në ngarkim të shtetasit Dh.I.

Nga përmbajtja e kallëzimit penal rezulton se nga kontrolli i ushtruar prej Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Vlorë janë konstatuar shkelje në dosjen e pensionit me nr. ***, që i përket shtetasit Dh. J. I. Nga verifikimi i dokumentacionit të ndodhur në dosje rezulton se me vendimin nr. ***, datë 18.9.1995, këtij shtetasi i është lidhur pension pleqërie i plotë.

Nga kontrolli i ushtruar ka rezultuar se nga certifikata familjare e paraqitur në vitin 1998 figuron me datëlindje 30.6.1943, kurse në regjistrin elektronik të gjendjes civile figuron me datëlindje 30.12.1943. Mbështetur në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, neni 97, nuk plotësohet kushti për të dalë në pension në datën 30.6.1993, por në datën 30.6.2005. Për sa më sipër, shtetasi Dh. I. rezulton debitor për periudhën 30.6.1993 – 30.6.2005. Masa e dëmit ekonomik është 731,917 lekë.

Në kuadër të hetimit të këtij procedimi penal janë kryer veprimet hetimore, si vijojnë:

- Në datën 26.9.2013, oficeri i policisë gjyqësore ka administruar dosjen e pensionit të shtetasit Dh. I.

- Nga administrimi i të dhënave të kësaj dosjeje rezulton se ky shtetas ka paraqitur kërkesën për përfitimin e pensionit të pleqërisë në datën 24.6.1993. Pjesë e dokumentacionit përkatës ka qenë edhe certifikata familjare lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Vlorë, në të cilën ky shtetas rezulton i datëlindjes 30.6.1943. Bazuar në këto dokumente, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore është marrë vendimi për caktimin e pensionit nr. ***, datë 18.9.1995, për shtetasin Dh. I., i datëlindjes 30.6.1943.

Pas konstatimit të parregullsive të mësipërme, DRSSH Vlorë ka nxjerrë urdhrin nr. ***, datë 19.7.2012, për mbylljen e pensionit nr. ***, që i përket shtetasit Dh.I, duke filluar nga data 1.8.2012. Ky urdhër i është drejtuar qendrës së pagimit të pensioneve përkatëse, duke urdhëruar mbylljen e urdhërpagesës.

Me shkresën nr. *** prot., datë 26.9.2013, të sektorit të Gjendjes Civile Bashkia Vlorë, është dërguar një kopje e certifikatës personale dhe familjare të shtetasit Dh. I., në të cilat figuron me datëlindje 30.12.1943.

Për sa më sipër, ka rezultuar i provuar fakti se mbi bazën e të dhënave të rreme shtetasi Dh. I. ka përfituar në mënyrë të padrejtë pension pleqërie për një periudhë dyvjeçare, duke i shkaktuar një dëm ekonomik institucioneve të shtetit, konkretisht ISSH-së. Referuar faktit që shtetasi Dh.I. ka paraqitur certifikatë të falsifikuar dhe me moshë më të madhe, 6 muaj, data kur ky shtetas do të përfitonte pension të ligjshëm do të ishte 30.6.2005. Pra, nga viti 1993 deri në vitin 2005 shtetasi Dh. I. ka përfituar pension të padrejtë nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara, konkretisht certifikatë të falsifikuar, duke konsumuar elementet e veprave penale “Falsifikimi i akteve të gjendjes civile” dhe “Mashtrimi në sigurime”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 191 dhe 145 të Kodit Penal. Në vitin 2005 ka përfunduar gjendja e paligjshmërisë, pasi duke filluar nga ky vit shtetasi Dh. I. ka fituar të drejtën për t’u trajtuar me pension pleqërie. Nga viti 2005 deri në datën 20.8.2013, kur është regjistruar procedimi penal, kanë kaluar 8 vjet.

Në kushtet e parashkrimit të ndjekjes penale, bazuar në nenin 328, shkronja “d”, prokurori ka vendosur: *Pushimin e çështjes për procedimin penal nr. *** të vitit 2013 etj.*

Nga shkresa nr. *** prot., datë 14.11.2019, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se ndaj vendimit të mosfillimit të prokurorit nuk është bërë ankim në Gjykatë.

Dosja nr. 4. Gjetjet në dokumentin ligjor “Vendim për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2014”. Akti është i datës 8.12.2014, përpiluar dhe nënshkruar nga Aurel Zarka, në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me anë të këtij akti prokurori, pasi ka përfunduar hetimet, ka arritur në konkluzionin se procedimi penal duhet të pushohet për shkak se vepra penale nuk ekziston.

Rrethanat e faktit: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në datën 27.5.2014, mbi bazën e kallëzimit penal të INUV Komuna Q Vlorë, ka regjistruar procedimin penal nr. *** të vitit 2014, për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal.

Nga tërësia e veprimeve hetimore dhe provave të administruara në lidhje me këtë procedim penal ka rezultuar e provuar se Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik i Komunës Q, Vlorë, ka konstatuar se shtetasja Q. H. ka kryer një ndërtim pa leje në vendin e quajtur ***. Nga ana e inspektorëve të INUV Komuna Q, Vlorë, është mbajtur procesverbali me nr. serie ***, datë 8.1.2014, ku është konstatuar kundërvajtja e mësipërme. Në funksion të hetimit është bërë këqyrja e vendit të ngjarjes, ku është shtëpi banimi rreth 90 m², e përfunduar me soletë.

Nga deklaratimet e shtetasve Sh. S. dhe L. B., të cilët punojnë si inspektorë pranë INUV Komuna Q, Vlorë, rezulton se ata kanë konstatuar ndërtim pa leje të kryer nga shtetasja Q. H. dhe për këtë fakt kanë mbajtur edhe procesverbalin përkatës, por nuk kanë pasur dijeni për kohën e saktë të ndërtimit të këtij objekti.

Nga deklarimi i shtetasës Q. H. rezulton se këtë ndërtim ajo e ka mbaruar se ndërtuari që në vitin 1998 (e ka ndërtuar pa leje meqë ishte e pastrehë).

Nga ALUIZNI Vlorë është kërkuar ortofoto për ***, ku është administruar ortofoto e këtij pylli, ndodhur në fshatin N, në anën jug-perëndimore të fushës së sportit.

Gjithashtu është kërkuar nga ALUIZNI Vlorë informacion për vetëdeklarimin për legalizim për ndërtimin e kryer nga shtetasja Q.H dhe nga përgjigja e ardhur me shkresën nr. *** prot., të vitin 2014, rezulton se kjo shtetase ka aplikuar për legalizimin e objektit informal me formularin nr. ***, datë 20.2.2005, ndodhur në fshatin N, Vlorë, për objektin me sipërfaqe ndërtimi 93 m² dhe sipërfaqe trualli të zënë 250 m².

Nga hetimet e zhvilluara për këtë procedim penal rezulton se shtetasja Q.H ka kryer një ndërtim pa leje, në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”.

Neni 199/a i Kodit Penal ka hyrë në fuqi në datën 27.11.2008.

Pra, duke pasur parasysh nenet 2 dhe 3 të Kodit Penal, ku shprehet qartë se askush nuk mund të dënohet penalisht për një veprë që më parë nuk është parashikuar shprehimisht në ligj si krim apo kundërvajtje penale, dhe askush nuk mund të dënohet për një veprë, që sipas ligjit të kohës kur është kryer nuk përbënte veprë penale, arrijmë në përfundimin se ndjekja penale për këtë procedim penal duhet të pushohet.

Nga sa më sipër, në bazë të nenit 328, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale, prokurori ka vendosur: *Pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2014, të regjistruar për kryerjen e veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal etj.*

Nga shkresa nr. *** prot., datë 14.11.2019, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, rezulton se ndaj vendimit të pushimit të prokurorit nuk është bërë ankim në Gjykatë.

Dosja nr. 5. Gjetjet në dokumentin ligjor “Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2015”. Akti është i datës 20.10.2015, përpiluar dhe nënshkruar nga Aurel Zarka në cilësinë e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Me anë të këtij akti, prokurori pasi ka përfunduar hetimet, ka arritur në konkluzionin se i pandehuri ka kryer veprë penale, provat në ngarkim të tij janë të plota dhe se duhet të gjykohet për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Në fillim të aktit prokurori paraqet të pandehurin N. H., akuzuar për veprën penale “Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë mbi bazën e kallëzimit penal të ardhur nga Komisariati i Policisë Vlorë, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 25.9.2015, për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Nga veprimet hetimore rezultoi se në datën 17.9.2015, rreth orës 08:00, në vendin e quajtur kryqëzimi i spitalit ka ndodhur një aksident rrugor, ku është konstatuar se shtetasi N.H, duke drejtuar motomjetin e tij tip “****” është përplasur me mjetin tip “****” me targë AA ***, me drejtues shtetasin R. B. Mjeti tip “****” ka qenë ndaluar dhe shtetasi R. B. ka hapur derën e mjetit dhe ka goditur motomjetin me drejtues shtetasin N. H., i cili është rrëzuar në asfalt.

Shtetasi N. H. ka deklaruar se ai ka qenë duke ecur me motor dhe kur ka qenë tek kryqëzimi i spitalit ka dashur të kalojë një mjet të ndaluar. Në atë kohë drejtuesi i mjetit hapi derën dhe e ka rrëzuar në tokë. Menjëherë ai e ka dërguar në spital për t'i dhënë ndihmë mjekësore. Shtetasi N. H. shpjegon se nuk është i pajisur me leje për drejtim automjeti. Të njëjtat fakte ka deklaruar edhe shtetasi R. B.

Nga akti i ekspertimit mjekoligjor nr. ***, datë 21.9.2015, rezultoi se dëmtimet e shtetasit N.H. sjellin humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën deri 9 ditë. Nga dokumentet e motomjetit tip “****” konstatohet se ai është 79 CC, me kilometrazh 100 km/h dhe numri i personave të ulur është 2. Edhe nga fotografitë e vendit e ngjarjes, dhe pikërisht nga fotografitë e motorit, konstatohet se motori tip “****” është me dy vende për t'u ulur.

Në kuadër të këtij procedimi është kërkuar informacion nga DRSHTRR Vlorë nëse shtetasi N.H. është i pajisur me leje për drejtim automjeti dhe nga përgjigjja e shkresës nr. *** prot., datë 2.10.2015, rezulton se shtetasi N. H., i datëlindjes 20.8.1939, rezulton të jetë i pajisur me leje për drejtim automjeti të kategorisë B nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Vlorë.

Nga sa më sipër, rezulton se i pandehuri N. H. ka konsumuar plotësisht veprën penale “Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal. I pandehuri e ka pranuar akuzën dhe është shprehur se ndihet i penduar. Rezulton se i pandehuri është i përgjegjshëm para ligjit dhe e ka mbushur moshën për përgjegjësi penale. Për vërtetimin e akuzës ndaj të pandehurit në këtë pjesë të aktit prokurori ka renditur provat që vetëtojnë akuzën.

Bazuar në nenin 331 të Kodit të Procedurë Penale, prokurori i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë: Gjykimin e çështjes penale nr. ***, datë 2.2.2015, në ngarkim të të pandehurit N. H., për kryerjen e veprës penale “Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Nuk janë konstatuar problematika lidhur me 5 çështjet e përzgjedhura me short.

Të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime

11. Nga informacioni i dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë rezulton se ndaj prokurorit Aurel Zarka nuk është dhënë asnjë masë disiplinore. Gjithashtu, në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme nuk u gjetën ankesa ku përmendet prokurori Aurel Zarka. Nga vlerësimet e Prokurorit të Përgjithshëm për prokurorin Aurel Zarka, që i përkasin punës së tij për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”.

12. Bazuar në përgjigjet e ardhura nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, për kallëzimet në të cilat përmendet prokurori Aurel Zarka, rezulton se ndaj tij nuk ka asnjë kallëzim penal.

Analiza e gjetjeve

13. Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara rezulton se prokurori Aurel Zarka, sa i përket periudhës së rivlerësimit, shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit.

14. Në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme.

15. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurori Aurel Zarka, për vitet 2012 – 2016, të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se për aftësitë profesionale në cilësinë e prokurorit, ai është vlerësuar “shumë mirë”.

16. Nga analiza e 3 dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë prokurori dhe vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të shortuara evidentohet se subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka shfaq aftësi në arsyetim ligjor.

17. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti Aurel Zarka ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuarra dhe numrit total në çështjeve të përfunduara për të gjithë periudhën e vlerësimit.

18. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

19. Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e rëna në short nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Aurel Zarka.

20. Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti Aurel Zarka rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuara brenda dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

DENONCIME

21. Për subjektin e rivlerësimit Aurel Zarka janë paraqitur pranë Komisionit 4 denoncime, të cilat rezultuan si vijon:

21.1 Denoncim nr. *** prot., datë 12.8.2020, i shtetasit A.Th

Ky shtetas ka paraqitur kërkesë pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe për dijeni i është drejtuar (krahas institucioneve të tjera) edhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka kërkuar përjashtimin e prokurorit Aurel Zarka, për shkak se ai është shprehur një herë për hetimin dhe me bindjen se e paragjykon çështjen, e cila është kthyer nga Gjykata, dyshon se prokurori do të shpallë përsëri mosfillimin e hetimit.

Në mungesë të informacionit të mëtejshëm të akteve ligjore, Komisioni i është drejtuar²⁹ Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, ku i ka kërkuar kopje të praktikës së ndjekur nga subjekti Aurel Zarka për çështjen, për të cilën shtetasi A.Th është ankuar ndaj këtij subjekti.

Ky institucion i është përgjigjur³⁰ Komisionit, duke shpjeguar se si rezultat i verifikimit në regjistrin e Prokurorisë rezulton të jetë regjistruar kallëzimi penal nr. *** për nenin 99 të Kodit Penal, për të cilin, pasi janë kryer veprimet përkatëse hetimore nga prokurori i çështjes Aurel Zarka, në datën 9.11.2017 është vendosur me vendim mosfillimi. Ky vendim është ankimuar

²⁹ Me kërkesën nr. *** prot., datë 5.4.2024, me lëndë “Kërkesë për informacion dhe dokumentacion”.

³⁰ Me praktikën nr. *** prot., datë 19.4.2024, me lëndë “Dërgim aktesh”.

në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila me vendimin nr. ***, datë 18.9.2018, ka vendosur regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “Mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal.

Në datën 5.3.2019, shtetasit A dhe E.Th (prindërit e të ndjerit L. Th.) kanë paraqitur kërkesë për zëvendësimin e prokurorit Aurel Zarka në hetimin e mëtejshëm të këtij procedimi penal dhe në datën 6.3.2019 prokurori ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga hetimi i çështjes penale, e cila është miratuar nga drejtuesi i Prokurorisë, z. A. Y, me vendimin e datës 7.3.2019.

Bashkëlidhur janë dërguar aktet e praktikës së ndjekur për këtë procedim penal nga prokurori Aurel Zarka dhe informacioni se aktualisht ky procedim penal është në hetim.

Sa më sipër, edhe në referim të nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, Komisioni vlerësoi se nuk ka *indicie* që subjekti i rivlerësimit të mund të hetohej më tej.

21.2 Denoncim nr. * prot., datë 1.2.2019, i shtetasës R.B**

Ky denoncim drejtohet edhe ndaj subjekteve të tjera (G. T. dhe O. Ç.) në lidhje me procedimin penal në ngarkim të bashkëshortit të saj E.B.

Denoncuesja ankohet ndaj subjektit të rivlerësimit kur ai ka qenë në cilësinë e oficerit të policisë gjyqësore në lidhje me faktin kur prokurori G. T. kërkon nisjen e hetimeve për shtetasin E. B në kuadër të një operacioni ku ishin arrestuar disa shtetas shqiptarë për lëndë narkotike, duke e dërguar OPGJ-në A. Zarka për t'i komunikuar E. B hapjen e procesit penal ndaj tij. Shtetasi E. B nuk kishte pranuar asgjë në këmbim të sekretit hetimor, që sipas denoncueses ky ishte një fakt që ata e dispononin me audio dhe video.

Sipas denoncueses, shtetasi E. B mbahet në paraburgim të krimeve të rënda një vit dhe më pas dënohet me 12 vite burg për një vepër penale që ai nuk e ka kryer dhe se Prokuroria nuk ka hetuar si duhet çështjen në fjalë.

Denoncuesja nuk ka paraqitur fakte dhe akte konkrete ku subjekti i rivlerësimit të mund të hetohej. Përkundrazi, denoncuesja fokusohet tek moskryerja e veprimeve hetimore nga ana e prokurorit pranë ish-Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë.

21.3 Denoncim nr. * prot., datë 8.9.2023, i shtetasit S.H**

Ky denoncim ka mbërritur pranë Komisionit nëpërmjet postës elektronike. Shtetasi S. H. është ankuar edhe për një tjetër prokurore krahas subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka, në lidhje me një vendim mosfillimi për një kallëzim penal të depozituar nga denoncuesi ndaj një notereje, e cila sipas tij ka kryer shkelje në lidhje me çeljen e trashëgimisë së xhaxhait të tij. Ky vendim mosfillimi objekt ankimi është depozituar bashkëlidhur denoncimit dhe prokurore është znj. M. P. dhe jo subjekti i rivlerësimit. Për këtë arsye, Komisioni vlerësoi se nuk kishte *indicie* që të mund të hetohej më tej për subjektin e rivlerësimit.

21.4 Denoncim nr. * prot., datë 5.5.2018, i shtetasit L.M**

Ky shtetas i është drejtuar Ambasadës Amerikane në Tiranë, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe disa zyrtarëve të pushtetit vendor, prokurorë e gjyqtarë, kryesisht të qytetit të Vlorës. Denoncuesi L. M ankohet në lidhje me një çështje pronësie të tokës që posedojnë nëna e tij E.M dhe vëllai i tij F.M, e cila u është shtetëzuar që në vitin 1946 dhe përdorur nga shteti për interesat e tij, e me gjithë kërkesat e vazhdueshme drejtuar pushtetit vendor ky problem nuk ka marrë zgjidhje.

Bashkëlidhur këtij ankimi, denoncuesi ka bashkëlidhur disa vendime mosfillimi procedimi me prokurorë të tjerë, të cilat kanë të bëjnë me kallëzime penale që kanë bërë nëna dhe vëllai i denoncuesit për vepra të ndryshme penale, siç është ajo e kanosjes, shpërdorimit të detyrës, etj., që nuk kanë lidhje me çështjen e tyre të pronësisë mbi tokën që posedojnë.

Në denoncim gjenden edhe disa vendime të prokurorit A. Zarka, i cili ka shqyrtuar çështjet në fjalë dhe ka vendosur mosfillimin e hetimit, përkatësisht: mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***, viti 2015; mosfillimin e procedimit penal për referimin penal nr. ***, viti 2017 dhe mosfillimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018.

Po kështu, edhe këto vendime kanë në përmbajtjen e tyre shqyrtime të materialeve hetimore që kanë të bëjnë me vepra penale si “Kanosja” etj., e për të cilat duket se subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit ka kryer veprimet e duhura hetimore. Ndërsa nuk u evidentuan shkelje apo mangësi profesionale ku Komisioni të mund të hetonte më tej.

Çështje të tjera

22. Pas përfundimit të hetimit nga Komisioni dhe dërgimit të rezultateve të hetimit subjektit të rivlerësimit, pranë Komisionit janë administruar edhe dy denoncime të tjera nga shtetasi B.T. dhe shoqata “****”, Himarë.

23. Pas analizimit të këtyre denoncimeve, Komisioni nuk evidentoi *indicie* mbi të cilat të mund të hetonte e më pas të mund të riçelte hetimin administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit.

Vlerësimi i Komisionit për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit

24. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv dhe konsiderohet “i aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të shkronjës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Aurel Zarka ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, referuar shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Aurel Zarka, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 28.6.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Suela ZHEGU
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Genta Tafa (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi